



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Matrica e Monitorimit

mbi Mjedisin Mundësues për
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

RAPORTI

PËR SHQIPËRINË 2016

Projekti financohet nga:
Bashkimi Evropian




B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

**OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER**



SWEDEN



BALKAN
CIVIL
SOCIETY
DEVELOPMENT
NETWORK



CENZURA PLUS



Centar
za razvoj nevladinih
organizacija

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TÜSEV
Türkiye Üçüncü Sektör Vakfı
Third Sector Foundation of Turkey



CPCD
Center za promociju civilnog društva

Civic
Initiatives



VESTA



OSOBINAR ASSOCIATION - BOSTON
"Center for Governance and Transparency in
Government & Non-Profit Organizations" INC., USA

Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike

Fuqizimi i Advokacisë,

Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve

Matrica e Monitorimit

mbi Mjedisin Mundësues për
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

RAPORTI

PËR SHQIPËRINË 2016



Projekti financohet nga:
Bashkimi Evropian



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

**OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER**



"Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, dhe Olof Palme International Center në Shqipëri nëpërmjet financimit të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Bashkimit Evropian, Olof Palme International Center dhe Qeverisë Suedeze."

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit "Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike-Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve" dhe "Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave"

Partner kryesor:

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)

Metropolit Teodosij Gologanov 39/II-2
1000-Shkup
Maqedoni
Tel.: + 389 (0)2 614 42 11
E-mail: executiveoffice@balkancsd.net
Website: www.balkancsd.net

Partner zbatues në Shqipëri:

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,
Kutia Postare (PO Box) 2418/1
Tel.: +355 4 2254881 Fax: +355 4 2254883
Email: partners@partnersalbania.org
<http://www.partnersalbania.org>

Botuar në Shqipëri, në Shkurt 2017

Drejtuese

Juliana Hoxha

Grupi i Vëzhgimit

Erila Haska
Kostandina Keruti
Maris Selamaj
Miklovana Jaku
Ornela Palushaj

Grupi i Administrimit të të Dhënave

Erila Haska

Grupi i Analizimit të të Dhënave dhe Hartimit të Raportit

Juliana Hoxha
Klotilda Tavani Kosta
Kostandina Keruti

Grafik Design: Arben Hamzallari

Tabela e Përmbajtjes

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri.....	6
Gjetjet kryesore.....	7
Rekomandimet kryesore të politikave	8
Rreth projektit dhe Matricës	10
I. HYRJE	11
Rreth raportit të monitorimit.....	11
Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile	11
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZhSHC) në Shqipëri.....	13
Karakteristika dhe sfida specifike në aplikimin e Matricës në Shqipëri	14
Mirënjohje dhe falënderime.....	15
II. METODOLOGJIA	16
Përmbledhje e përjasjes metodologjike.....	16
Vështrim Literature	16
Vëzhgimi	16
Pjesëmarrja e komunitetit të OSHC-ve	17
III. GJETJET DHE REKOMANDIMET	19
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive.....	19
Nën-fusha 1.1 Liria e Organizimit	19
Nën-fusha 1.2 Liritë e tjera.....	24
Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të	26
Nën-fusha 2.1 Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre.....	26
Nën-fusha 2.2 Mbështetja e shtetit	30
Nën-fusha 2.3 Burimet njerëzore	34
Fusha 3: Marrëdhënia Shtet - OSHC	37
Nën-Fusha 3.1 Kuadri Ligjor dhe praktik për bashkëpunim	37
Nën-fusha 3.2 Përfshirja në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes	39
Nën-fusha 3.3 Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve	45
IV. BURIME TË PËRDORURA	47
V. ANEKSE	48

I. Përmbledhje Ekzekutive

Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri

Kuadri ligjor mbi garancitë themelore juridike të lirisë për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) i garanton të gjithë individëve dhe subjekteve të drejtën për të themeluar, regjistruar, bashkuar dhe për të marrë pjesë lirisht pa diskriminim në organizata formale dhe/apo jo formale, online dhe offline. Praktika tregon që kuadri ligjor rregullator mbi regjistrimin e OSHC-ve paraqet disa çështje problematike lidhur me procesin e centralizimit të regjistrimit/ri-regjistrimit, kohëzgjatjen e procedurave dhe koston e lartë për regjistrimin e OSHC-ve. Ka ende mungesë të informacionit zyrtar mbi numrin e OSHC-ve, fushën e veprimtarisë, shpërndarjen gjeografike, format ligjore, numrin e punonjësve dhe vullnetarëve, xhiron vjetore dhe burimet e financimit.

Për sa i përket qëndrueshmërisë dhe lehtësisë financiare, donatorët e huaj vazhdojnë të mbeten burimi kryesor financiar për OSHC-të, ndërkohë që financimi publik disponibël konsiderohet i pamjaftueshëm për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e OSHC-ve. Transparenca dhe përgjegjshmëria për shpërndarjen e fondeve publike nga institucionet publike mbeten ende për t'u përmirësuar, në mënyrë që këto fonde t'u përgjigjen sa më mirë nevojave të OSHC-ve. Gjithashtu, incentivat ligjore për dhurimet individuale dhe të korporatave nuk stimulojnë dhurimet për OSHC-ve.

Duke iu referuar trajtimit fiskal / tatimor të OSHC-ve, regjistrimi i OSHC-ve automatikisht në skemën

e TVSH-së, edhe pse ato nuk janë subjekt i TVSH-së, mbetet një çështje e pazgjidhur. OSHC-të duhet të paraqesin një kërkesë tek organet tatimore për t'u ç'regjistruar nga TVSH-ja. Gjithashtu, një çështje e vazhdueshme problematike mbetet rimbursimi i TVSH për projektet e IPA-s si dhe mungesa e rimbursimit të TVSH-së për programe të tjera financimi të BE-së, të cilat nuk janë subjekt i marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit të BE-së. Kjo situatë përbën një barrë të konsiderueshme dhe pengon OSHC-të shqiptare të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga këto programe.

Në prill të vitit 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 45/2016 "Për Vullnetarizmin", me qëllim rregullimin e punës vullnetare dhe rritjen e aktiviteteve jo-fitimprurëse të qytetarëve për mirëqenien e individëve të tjerë dhe publikut të gjerë. Megjithatë, aktet ligjore që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit, si: regjistri i kontratave vullnetare, librezat e vullnetarit, dhe kodi etik mbi vullnetarizmin, mbeten ende për t'u miratuar.

Duke iu referuar bashkëpunimit Shtet – OSHC, në qershor të vitit 2016 u krijua Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, një organ konsultativ me qëllim garantimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet shtetit dhe shoqërisë civile në Shqipëri. Këshilli ka 27 anëtarë, përfaqësues të qeverisë dhe OSHC-ve. Një nga detyrat e para që pritet nga Këshilli është përgatitja dhe monitorimi i

zbatimit të Strategjisë Kombëtare për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile. Këshilli duhet ende të provojë që është struktura kryesore që kontribuon në krijimin e një mjedisi mundësues për OSHC-të.

Kuadri ligjor ekzistues për informimin dhe konsultimin publik, konkretisht Ligji Nr. 119/2014 "Mbi të Drejtën e Informimit" dhe Ligji Nr. 146/2014 "Mbi Njoftimin dhe Konsultimin Publik" i garanton të drejtën qytetarëve për informim mbi informacionin që përgatitet apo disponohet nga autoritetet publike. Gjithashtu, ligjet garantojnë që publiku të konsultohet për projektligje, draft dokumente dhe strategji kombëtare dhe lokale, si dhe për politika me interes të lartë publik, duke rritur transparencën dhe pjesëmarrjen publike në procesin politikëbërës dhe vendimmarrës. Pavarësisht ndikimit pozitiv që kanë pasur këto ligje në fushat respektive, ka akoma nevojë për përmirësime që sigurojnë konsultimin dhe pjesëmarrjen efektive të OSHC-ve dhe publikut në procesin e politik-bërjes dhe vendim-marrjes. Zbatimi efektiv i këtyre ligjeve nga autoritetet publike kërkon gjithashtu krijimin e mekanizmave të parashikuara në to.

Kuadri ligjor dhe praktik mbi përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve nuk është inkurajues, duke rezultuar në shumë pak marrëveshje kontraktuale ndërmjet Shtetit dhe OSHC-ve. Ligji nr. 65/2016, datë 9.6.2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë" parashikon format e mbështetjes për ndërmarrjet sociale si subvencionet shtetërore për ndërmarrjet ose të punësuarit në këto subjekte, taksat dhe dhurimet. Ligji inkurajon pushtetin vendor për të nxitur pjesëmarrjen e ndërmarrjeve sociale në tenderat publikë për shërbimet sociale, shëndetësore dhe kulturore. Aktet nën-ligjore, të cilat do të mundësonin zbatimin e ligjit, ende nuk janë përgatitur dhe bërë publike.

Gjetjet kryesore

Ky seksion përmban gjetjet kryesore nga Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile Në Shqipëri në vitin 2016, bazuar në procesin e monitorimit të kuadrit ligjor dhe rregullator dhe zbatimit të tij në praktikë.

Kuadri ligjor për krijimin dhe regjistrimin e OSHC-ve nuk ka ndryshuar gjatë vitit 2016. Edhe këtë vit regjistrimi dhe ri-regjistrimi i OSHC-ve paraqet problematika për sa i përket centralizimit të procesit të regjistrimit/ri-regjistrimit, koston e lartë dhe kohëzgjatjes së procedurave të regjistrimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës.

Kuadri ligjor ekzistues nuk paraqet ndonjë pengesë për OSHC-të për të kërkuar dhe siguruar lirisht fonde financiare nga burime të brendshme dhe të jashtme. Megjithatë, donatorët e huaj mbeten akoma burimi kryesor financiar për OSHC-të, si për sa i përket numrit të OSHC-ve të financuara, ashtu dhe shumës së fondeve të donatorëve të huaj që kontribuojnë në të ardhurat totale të OSHC-ve.

Ligji i ri për TVSH-në, Ligj nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", parashikon përjashtim nga taksat për të gjitha grantet që mbështesin veprimtarinë jo-fitimprurëse të OSHC-ve. Megjithatë, bazuar në përvojën e OSHC-ve, duhet përmirësuar kuptimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor fiskal që ndikon tek OSHC-të, si nga institucionet shtetërore ashtu edhe nga vetë OSHC-të.

Ligj nr. 7892, datë 21.12.1994, "Për Sponsorizimet", i përdtësuar, është i vetmi ligj që rregullon dhurimet në Shqipëri. Sipas dispozitave ligjore, incentivat fiskale për rastet e dhurimeve nga korporatat nuk janë të favorshme dhe stimuluese për dhurime ndaj OSHC-ve. Dhurimet individuale nuk janë të përfshira në skemat e zbritjes.

Pas disa vitesh diskutimi, në Prill të vitit 2016 u miratua Ligji për vullnetarizmin. Ligji përcakton parimet kryesore, kushtet dhe kriteret për kryerjen e punës vullnetare në Shqipëri. Zbatimi i ligjit është vonuar, për shkak se aktet nënligjore të përcaktuara në ligj nuk janë përgatitur dhe miratuar ende nga Këshilli i Ministrave.

Kuadri ligjor parashtron nevojën për konsultim mbi projektligjet dhe politikat me publikun. Përfshirja e OSHC në vendimmarrje, dhe kontributi i OSHC-ve në kohën e duhur, nuk mundësohet plotësisht në praktikë. OSHC-të nuk konsultohen dhe nuk përfshihen efektivisht në proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse.

Nr	6 Gjetjet kryesore të studimit	Referenca Matrica e Monitorimit		Referenca Udhërrëfyese i BE-së.	
		Fusha		Objektivi	
1	Procesi i regjistrimit dhe ri-regjistrimit për OSHC-të nuk është mundësues për sa i përket: centralizimit të regjistrimit dhe ri-regjistrimit, kostos së lartë dhe kohës së zgjatur.	Fusha 1	1	Objektivi	1
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	1.1
2	Donatorët e huaj mbeten burimi kryesor i financimit për OSHC-të, për sa i përket numrit të OSHC-ve të financuara dhe shumës së fondeve të tyre në të ardhurat totale të OSHC-ve.	Fusha	1	Objektivi	
		Nën-fusha	1.2	Rezultati	
3	Mbetet problematik zbatimi korrekt nga autoritetet shtetërore i kuadrit ligjor fiskal që ndikon në aktivitetet e OSHC-ve dhe kuptueshmëria e saktë e kuadrit fiskal nga vetë OSHC-ve.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-fusha	2.1	Rezultati	2.3
4	Kuadri ligjor nuk është mbështetës dhe nuk stimulon dhurimet individuale dhe të korporatave kundrejt OSHC-ve. Niveli i incentivave fiskale në legjislacionin ekzistues nuk motivon dhurimet e korporatave, dhe nuk ka incentiva fiskale ndaj dhurimeve individuale.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-Fusha	2.2	Rezultati	2.2
5	Ligji mbi vullnetarizmin nuk zbatohet duke qënë se aktet nën-ligjore, të cilat rregullojnë marrëdhënien ndërmjet vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit, si: regjistri i kontratave të vullnetarëve, librezat e vullnetarit, dhe kodi etik i vullnetarizmit, nuk janë përgatitur dhe miratuar ende.	Fusha	2	Objektivi	1
		Nën-fusha	2.3	Rezultati	1.2.
6	OSHC-të nuk konsultohen dhe nuk përfshihen efektivisht në proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse. Rekomandimet e tyre nuk merren parasysh duke mos argumentuar arsyen e mos konsiderimit, në kundërshtim me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.	Fusha	3	Objektivi	3
			3.2	Rezultati	3.1

Rekomandimet kryesore të politikave

Ky seksion paraqet rekomandimet kryesore bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator ekzistues, si dhe në eksperiencën e OSHC-ve.

Një nga rekomandimet kryesore të këtij raporti është decentralizimi i regjistrimit dhe ri-regjistrimit të OSHC-ve. Distanca nga autoriteti i regjistrimit dhe kostoja e regjistrimit nuk duhet të përbëjnë pengesa për individët dhe entitetet, të cilët kërkojnë të regjistrojnë një OSHC.

Mbështetja financiare dhe qëndrueshmëria e OSHC-ve vazhdon të jetë një nga dobësitë e sektorit, prandaj duhet të ndërmerren veprime konkrete në këtë fushë. Përveç rritjes së fondeve publike për OSHC-të, nevojitet edhe krijimi i një mjedisi mundësues për zhvillimin e filantropisë dhe stimulimit të dhurimeve individuale dhe të korporatave ndaj OSHC-ve.

Trajtimi fiskal është një nga elementet kyç në veprimtarinë e OSHC-ve. Pavarësisht zhvillimeve në përgatitjen e kuadrit ligjor, i cili ofron lehtësira dhe kërkesa raportimi më të lehta ndaj OSHC-ve, nevojitet qartësimi të mëtejshme shoqëruar me zbatimin korrekt të kuadrit ligjor nga organet tatimore, si dhe nevojitet kuptueshmëria e saktë ligjore nga ana e OSHC-ve.

Miratimi i ligjit për vullnetarizmin në 2016, si një nga fushat prioritare të Udhërrëfyesis për Hartimin e Politikës dhe Masave Për Një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile, përfaqëson hapat e para të zhvillimit të vullnetarizmit në vend. Për zbatimin e ligjit duhet të plotësohet kuadri ligjor me aktet nën-ligjore të parashikuara në ligj. Konsiderohet i nevojshëm komunikimi dhe ndërveprimi i mëtejshëm ndërmjet anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, (i cili është në vitin e parë të krijimit të tij), dhe OSHC-ve të tjera, në mënyrë që të rritet efektiviteti i punës së Këshillit.

Është i dukshëm përmirësimi për sa i përket konsultimeve dhe përfshirjes së OSHC-ve në proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse, për sa i përket numrit të konsultimeve të organizuara dhe numrin e OSHC-ve të ftuara dhe që marrin pjesë në konsultime. Megjithatë, përfshirja efektive e OSHC-ve në proceset vendim-

marrëse mbetet e kufizuar, dhe në shumicën e rasteve nuk ka asnjë informacion për rezultatet e konsultimeve dhe asnjë argumentim për arsyet se pse rekomandimet nuk janë marrë parasysh, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".

Nr	6 rekomandimet më të rëndësishme për reformën	Referenca Matrica e Monitorimit		Referenca Udhërrëfyese i BE-së.	
		Fusha		Objektivi	
1	Decentralizimi i procesit të regjistrimit dhe ri-regjistrimit të OSHC-ve në nivel vendor.	Fusha	1	Objektivi	1
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	1.1
2	Krijimi i një mjedisi mundësues ligjor dhe praktik për të inkurajuar dhurimet individuale dhe të korporatave për OSHC-të, përmes njohjes dhe qartësimit të dhurimeve filantropike në kuadrin ligjor, rishikimin e incentivave fiskale për donatorët dhe krijimin e platformave të bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe sektorit të biznesit.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-fusha	2.2	Rezultati	2.2
3	Zbatimin korrekt i kuadrit ligjor për OSHC-të nëpërmjet: (a) rritjes së kuptueshmërisë së organeve tatimore për natyrën, rolin dhe vlerën e OSHC-ve; (b) rritjes së informacionit dhe ndërgjegjshmërisë të OSHC-ve mbi rregullat dhe kërkesat e raportimit në shtet.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-fusha	2.1	Rezultati	2.3
4	Rritje e efektivitetit të punës së Këshillit Kombëtar për Shoqërisë Civile dhe ndërveprim më i mirë midis anëtarëve të tij dhe me OSHC-të e tjera.	Fusha	3	Objektivi	
		Nën-fusha	3.1	Rezultati	
5	Përfshirja e duhur e OSHC-ve në proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse nëpërmjet zbatimit korrekt të Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-fusha	3.2	Rezultati	3.1
6	Plotësimi i kuadrit ligjor për Vullnetarizmin nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet përgatitjes dhe miratimit të akteve nën-ligjore të cilat rregullojnë marrëdhënien ndërmjet vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit, si: regjistri i kontratave për vullnetarët, librezat e vullnetarit, dhe kodi etik për vullnetarizmin. Nevojitet gjithashtu rishikimi i kuadrit ligjor fiskal për të rregulluar trajtimin fiskal të aktivitetit vullnetar.		2.3	Rezultati	1.2

Rreth projektit dhe Matricës

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të “Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve”, një projekt i financuar nga BE dhe Balkan Trust for Democracy (BTD). Ky raport monitorimi është i vetmi raport i këtij lloji i cili publikohet çdo vit që prej vitit 2013. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (ZSHHC) zhvilluar nga BCSDN dhe ECNL. Raporti është pjesë e një serie raportimesh nga 7 vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqia. Përgatitet edhe një Raport i Monitorimit Rajonal, i cili përmbledh të dhënat dhe rekomandimet e të gjitha vendeve, si edhe një platformë rrjeti online që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve dhe nën-fushave, tek www.monitoringmatrix.net.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për veprimtarinë e OSHC-ve. Matrica është

e organizuar në tre fusha, secila fushë është e ndarë në nënfusha: (1) Garancitë Themelore Juridike të Lirive; (2) Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të; (3) Marrëdhënia Qeveri - OSHC.

Parimet, standardet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë në konsideratë stadin e zhvillimit të sektorit dhe diversitetin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato mbështeten në garantimin e lirive dhe të drejtave ndërkombëtare dhe në praktikën rregullatore më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës. Matrica synon të përcaktojë një situatë optimale të dëshiruar për shoqërinë civile e cila funksionon dhe zhvillohet në mënyrë efektive dhe synon gjithashtu të vendosë një kuadër ligjor sa me realist, i cili të mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke patur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë kryesisht në zbatim, indikatorët janë përcaktuar për të monitoruar situatën në nivelin e kuadrit ligjor dhe aplikimit praktik të tij.

II. Hyrje

Rreth raportit të monitorimit

Si pjesë e nismës “Acquis e Shoqërisë Civile në Ballkan - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve”, dhe “Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave”, Partnerët Shqipëri realizoi për të katërtin vit rradhazi studimin që rezultoi në Raportin e Matricës të Monitorimit 2016 (Raporti i MM 2016).

Ky raport monitorimi synon të prezantojë një pasqyrë të çështjeve që lidhen me mjedisin mundësues të OSHC-ve në Shqipëri si dhe rekomandime se si këto çështje mund të adresohen dhe të zgjidhen.

Raporti i Matricës së Monitorimit 2016, i përgatitur nga Partnerët Shqipëri, bazohet në një shqyrtim të legjislacionit shqiptar, politikave, studimeve dhe raporteve të përdorura për të vlerësuar treguesit ligjorë të Matricës së Monitorimit, si dhe mbi një vëzhgim, intervista të thelluara dhe takime konsultuese me OSHC-të për të vlerësuar treguesit praktikë të Matricës.

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Objektivi i përgjithshëm i projektit është fuqizimi i themeleve për monitorimin dhe advokacinë

mbi çështjet e lidhura me mjedisin mundësues dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile në nivel rajonal dhe vendor si edhe fuqizimi i strukturave për integrimin dhe pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikën e BE dhe procesin e pranimin në nivel Evropian dhe vendor.

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis e Shoqërisë Ballkanike - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues

dhe Kapaciteteve të OSHC-ve” financuar nga BE dhe nga Balkan Trust for Democracy (BTD). Ky raport monitorimi është i vetmi raport i këtij lloji i cili publikohet çdo vit që nga viti 2013. Ky raport monitorimi bazohet në Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe është pjesë e një serie raportimesh nga 7 vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqia. Gjithashtu, një Raport Monitorimi Rajonal, i cili përmbledh të dhënat dhe rekomandimet e të gjitha vendeve, si edhe një platformë rrjeti-online që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve dhe nën-fushave, janë të disponueshme tek www.monitoringmatrix.net.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për veprimet e OSHC-ve. Ajo nënvizon faktin se mjedisi mundësues është një koncept kompleks, i cili përfshin fusha të ndryshme dhe varet nga faktorë të ndryshëm, nga faza e zhvillimit të shoqërisë dhe nga sektori i shoqërisë civile.

Kjo Matricë nuk synon të përfshijë të gjitha çështjet e mjedisit mundësues. Matrica analizon ato që ekspertët kanë përcaktuar si më të rëndësishme për vendet në të cilat ata kryejnë veprimtarinë e tyre. Megjithatë, standardet janë formuluar duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të zhvillimit të sektorit dhe diversitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë.

Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha:

1. Garancitë Themelore Juridike të Lirive;
2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të;
3. Marrëdhënia Qeveri-OSHC.

Ato janë hartuar mbi eksperiencat e OSHC-ve të këtyre vendeve në termat e mjedisit ligjor si edhe praktikës e sfidave në zbatimin e tij. Zhvillimi i parimeve, standardeve dhe indikatorëve është realizuar duke marrë në konsideratë garantimin e lirive dhe të drejtave ndërkombëtare si edhe praktikën më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës.

Fushat janë përcaktuar sipas parimeve kryesore të cilat zhvillohen më tej sipas standardeve specifike. Nga ana e tyre, standardet shpjegohen më tej përmes indikatorëve, në mënyrë që t'i japin OSHC-ve lokale, donatorëve apo palëve të tjera të interesuara mundësinë për të parë e monitoruar mjedisin ligjor dhe praktikën e aplikimit të tij. Matrica e plotë gjendet në www.monitoringmatrix.net

Puna për përgatitjen e Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, ishte pjesë e një përpjekjeje të përbashkët të ekspertëve të OSHC-ve dhe praktikuesve nga rrjeti i anëtarëve e partnerëve të BCSDN dhe me ekspertë e mbështetjeje strategjike nga ECNL. Skuadra me 11 anëtarë ekspertë përfshiu një mori njohurish e eksperiencash nga OSHC dhe organizata jo-fitimprurëse, si ligjore ashtu edhe praktike, dhe përfshinte ekspertë nga 10 vende të Ballkanit. Puna me Matricën përfshiu takimet e punës si edhe punën online nga ekspertët, e cila u shqyrtua më tej nëpërmjet fokus-grupeve me aktorë të ndryshëm si edhe konsultimeve

publike. Puna mbi përpunimin e Matricës u mbështet nga USAID, Pact. Inc, dhe ICNL brenda Programit të Mjedisit Mundësues Ligjor (LEEP)/ Grantit të Inovacionit Ligjor dhe Balkan Trust for Democracy (BTD).

Përveç monitorimit të thelluar cilësor, në vitin 2015 u prezantua edhe shkalla me 5 nivele (kode), e quajtur ndryshe "Shkalla Semafor" duke filluar nga: (1) Mjedis aspak mundësues deri në (5)-Mjedis plotësisht mundësues dhe (0) Mungesë të dhënash. Ky sistem i ri u krijua si nevojë për të përmbledhur gjetjet dhe për t'i prezantuar ato vizualisht. Gjithashtu, mundëson prezantimin efektiv dhe sistematik të ndryshimeve të standardeve përgjatë shteteve dhe viteve për mjedisin mundësues të Zhvillimit të Shoqërisë Civile. Sistemi nuk e zëvendëson, por e plotëson vlerësimin cilësor, pasi raportet narrative të shteteve përbëjnë bazën mbi të cilën bëhet kategorizimi.

Gjithashtu, prezantimi i sistemit të kategorizimit mundëson standardizimin e cilësisë së Raportëve të Shteteve dhe Raportëve Rajonale dhe kontribuon në vlerësimin më efektiv të indikatorëve të Matricës së Monitorimit. Ndërsa elementët sasiorë janë përdorur për të bashkuar pikët teknikisht të mundshme, prezantimi vizual i të gjithave bëhet nëpërmjet etiketave përshkruese të kategorive. Tabela 1 paraqet etiketat përshkruese të kategorive dhe rezultatet për secilën kategori, si për legjislacionin ashtu edhe praktikën.

Kategoria/Kodi	Legjislacioni	Praktika	Pikat
Mjedis Aspak Mundësues	Legjislacioni është totalisht kufizues dhe në kundërshtim me standartet e MM ¹ Është kufizues për OSHC-të dhe përfaqësuesit e tyre dhe pengon në mënyrë serioze punën e tyre.	Standartet e MM janë krejtësisht kufizuese/ shkelen në praktikë duke penguar veprimtarinë e OSHC-ve dhe të përfaqësuesve të tyre gjatë veprimtarisë. Praktikën e këqija dhe kufizimet janë të zakonshme, ekzistojnë kërcënime kundrejt OSHC-ve/përfaqësuesve të tyre duke ndikuar plotësisht në punën e tyre.	1
Mjedis Jo Mundësues	Legjislacioni është kufizues dhe nuk është në përputhje me standartet e MM. Është kufizues dhe vështirëson veprimtarinë e OSHC-ve dhe përfaqësuesve të tyre, por lejon disa hapësira për veprimtarinë e tyre dhe punën e përfaqësuesve të tyre.	Standartet e MM nuk plotësohen/janë të pakënaqshme. OSHC-të pengohen; përballen me sfida të konsiderueshme gjatë veprimtarisë së tyre, por pavarësisht vështirësive serioze, OSHC-të dhe përfaqësuesit e tyre mund të punojnë.	2
Mjedis Pjesërisht Mundësues	Legjislacioni është pjesërisht në përputhje me standartet e MM, dhe vihen re kufizime ose çështje të vogla ligjore të pa rregulluara.	Standartet e MM arrihen pjesërisht/ janë të kënaqshme në praktikë. Nuk janë të zakonshme shkeljet e rënda, por raportohen kufizime të vogla dhe vështirësi në punën e OSHC-ve dhe përfaqësuesve të tyre.	3
Mjedis Mundësues	Legjislacioni është në përputhje me standartet e MM.	Standartet e MM respektohen/ janë të kënaqshme në praktikë. Raportohen shumë pak ose aspak raste të shkeljeve të vogla, kufizimeve ose pengesave të veprimtarisë së OSHC-ve dhe përfaqësuesve të tyre.	4
Mjedis Plotësisht Mundësues	Legjislacioni është plotësisht në përputhje me standartet e MM. Ka raste kur legjislacioni i tejkalon standartet dhe parimet e parashikuara në MM.	Standartet e MM respektohen plotësisht/ janë të kënaqshme në praktikë dhe zbatimin i legjislacionit është një proces rutinë nga të gjitha palët e përfshira. Ka raste që praktikën e mira i tejkalojnë standartet dhe parimet e parashikuara në MM.	5

Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZhSHC) në Shqipëri

Bazuar në kuadrin ligjor, Shqipëria ka tre forma organizatash jo-fitimprurëse, që janë: shoqatat, fondacionet dhe qendrat. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në shoqëri duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh, nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e reformave publike, si dhe përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik. Shumica e

OSHC-ve janë të vendosura në qytetet më të mëdha në vend, si Tiranë, Shkodër, Vlorë,² etj., ndërsa veprimtaria e tyre është e shpërndarë edhe në zona të tjera të vendit. Organizatat e vogla akoma nuk përfaqësohen denjësisht dhe shumica e OSHC-ve kanë staf mbi bazë projektesh³.

Një nga sfidat e hasura gjatë këtyre dekadave për sa i përket OSHC-ve është mungesa e të dhënave

- 1) Standartet e Matricës së Monitorimit janë zhvilluar duke marrë në konsideratë garantimin e lirive dhe të drejtave ndërkombëtare të sanksionuara në ligjin ndërkombëtar dhe praktikën më të mira rregullatore në nivel rajonal.
- 2) Të dhënat janë marrë nga Regjistri i OSHC-ve publikuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. <http://www.amshc.gov.al/web/ojf/>
- 3) Raporti i Indeksit të Qëndrueshmërisë I vitit, fq.15 https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1861/Europe_Eurasia_CSOSIReport_2015_Update8-29-16.pdf

zyrtare lidhur me regjistrimin dhe veprimtarinë e organizatave. Të dhënat e mundësuar nga autoritetet shtetërore për numrin e OSHC-ve janë kontradiktore. Numri total i OSHC-ve të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, që përfshin fondacione, shoqata dhe qendra, është 7,036¹⁴. Ka një ulje në numër të OSHC-ve të reja të regjistruara krahasuar me vitin e mëparshëm. Nga 489 OSHC të regjistruara në vitin 2015, numri shkoi në 307 në 2016 respektivisht 221 shoqata, 60 qendra, dhe 26 fondacione. Bazuar në të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹⁵, numri total i OSHC-ve të regjistruara është 3720, prej të cilave 283 OSHC janë regjistruar në 2016.

Një sfidë kryesore për OSHC-të mbetet qëndrueshmëria financiare e tyre. Sektori vazhdon të jetë financiarisht i varur nga donatorët, dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbën burimin kryesor të të ardhurave të OSHC-ve. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) vazhdon të jetë institucioni kryesor publik, i cili ka qëllim inkurajimin e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile përmes mbështetjes financiare nga shteti, dhe krijimin e kushteve të favorshme për iniciativat qytetare nga të cilat përfiton publiku. Mbështetja financiare nga shteti, ashtu si dhe tregohet në Raportet vjetore të Matricës së Monitorimit (2013, 2014, 2015 dhe 2016), vazhdon të mbetet në nivele të pamjaftueshme për veprimtarinë e OSHC-ve. Mbështetja financiare për zhvillimin institucional të OSHCve, si një nga format e mbështetjes që Agjencia duhet të ofrojë për OSHCtë, ende mbetet për t'u zbatuar.

Gjatë tre viteve të fundit, Parlamenti dhe Qeveria kanë aprovuar ligje dhe hartuar strategji për të rritur dialogun dhe bashkëpunimin me OSHC-të, tw tilla si: Rezoluta për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile; Ligji për të Drejtën e Informimit; Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik; Udhërrëfyeni për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile; si dhe Ligji për Krijimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Këto iniciativa kanë kontribuar në rritjen e konsultimit dhe bashkëpunimit ndërmjet

shtetit dhe OSHC-ve. Megjithatë, përmirësime të mëtejshme nevojiten në kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij praktik për të siguruar një dialog më kuptimplotë dhe përfshirjen e OSHC-ve në politik-bërje dhe vendim-marrje.

Karakteristika dhe sfida specifike në aplikimin e Matricës në Shqipëri

From the launch of the monitoring cycle in Që nga nisja e ciklit monitorues të mjedisit mundësues për shoqërinë civile në vitin 2013, Partnerët Shqipëri ka synuar një proces gjithëpërfshirës përgjatë përgatitjes së Raportit të Matricës së Monitorimit (MM), duke e prezantuar dhe diskutuar Matricën me një numër të madh përfaqësuesish të OSHCve në të gjithë vendin. Një numër prej 300 OSHC-ve nga 14 bashki të Shqipërisë u kontaktuan dhe u kërkua opinioni i tyre për studimin dhe përgatitjen e Raportit të MM për vitin 2016. Vetëm 96 nga OSHC-të e kontaktuar u përgjigjën dhe u përfshinë në studim.

Studimi i OSHC-ve u krye nëpërmjet një pyetësoi të standardizuar, duke theksuar indikatorët e nivelit të praktikës së Matricës së Monitorimit për Mjedisin Mundësues për OSHC-të. Intervista më të thelluara u realizuan pas sondazhit për të shqyrtuar çështjet apo fushat kontradiktore dhe për të marrë informacion plotësues me qëllimin analizimin e plotë të situatës.

Duke marrë parasysh sfidën e mungesës së të dhënave zyrtare publike mbi sektorin (numrin e OSHC-ve, formën e regjistrimit, shpërndarjen gjeografike, pjesën që zë secila OSHC lidhur me fushën e aktiviteteve, etj.), Partnerët Shqipëri dërgoi letra zyrtare tek Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për të marrë informacion lidhur me numrin e OSHCve të regjistruara në këto institucione për periudhën Dhjetor 2015 - Shtator 2016.

Po kështu iu dërguan letra të gjitha ministrive mbi proceset konsultuese dhe shumën e fondeve publike që u është akorduar OSHCve për periudhën e monitorimit, si dhe Kuvendit të Shqipërisë mbi konsultimin e projekt-ligjeve.

Intensiteti i punës brenda një kohe të kufizuar

- 4) Të dhënat janë marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në kërkesen e PSH për numrin e OSHCve të regjistruara në përputhje me ligjin " Për Organizatat Jofitimprurëse"
- 5) Të dhënat janë marrë bazuar në kërkesen e PSH për numrin e OSHCve të regjistruara në përputhje me ligjin " Për Organizatat Jofitimprurëse"

ishite një sfidë për grupin e vëzhgimit të përfshirë në mbledhjen e të dhënave dhe administrimin e tyre.

Mirënjohje dhe falënderime

Raporti i Matricës së Monitorimit të vitit 2016 mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri u përgatit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e OSHCve, ekspertëve dhe individëve.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen drejtorëve ekzekutivë dhe

manaxherëve të nivelit të lartë të OSHCve, të cilët morën pjesë në këtë studim për bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e përkushtuar.

Partnerët Shqipëri falënderon për bashkëpunimin dhe korrektësinë institucionet publike që iu përgjigjën kërkesës me informacionin e kërkuar.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), Qendrës Evropiane për Ligjin Jofitimprurës për mbështetjen e tyre në zhvillimin, orientimin dhe zbatimin e kësaj përpjekje monitoruese.

III. Metodologjia

Përmbledhje e përfaqësues metodologjike

Procesi për përgatitjen e Raportit të MM (Matricës së Monitorimit) për vitin 2016 u realizua gjatë periudhës Shtator – Dhjetor 2016. Partnerët Shqipëri përdori një sërë instrumentash metodologjikë, duke përfshirë hulumtimin e literaturës, marrjen e të dhënave dhe informacioneve parësore nëpërmjet pyetësorëve me përfaqësuesit e OSHC-ve, intervista të thelluara dhe konsultime me drejtorët ekzekutivë dhe manaxherë të nivelit të lartë të OSHC-ve.

Qëllimi kryesor ishte monitorimi i legjislacionit dhe indikatorëve të praktikës për të identifikuar progresin apo regresin e mjedisit mundësues duke përfshirë: klimën e përgjithshme, legjislacionin dhe efektivitetin e zbatimit të tij për veprimtarinë e OSHCve në Shqipëri.

Metodat e përdorura për përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit, 2016 janë si më poshtë:

1. Vështrim Literaturë

Duke marrë parasysh që Raporti i Monitorimit përmban indikatorë rreth legjislacionit dhe praktikës, rishikimi i literaturës u realizua përmes:

Rishikimit të kuadrit ligjor – me qëllim monitorimin e kuadrit ligjor dhe rregulloret e hartuara dhe aprovuara për një mjedis mundësues për OSHC-të. Rishikimi përfshiu shqyrtimin dhe analizimin e legjislacionit shqiptar (duke përfshirë vendimet rregulluese), si dhe analizën mbi zbatimin e konventave dhe rregulloreve ndërkombëtare të miratuara nga Shqipëria.

Vlerësimi të indikatorëve të praktikës bazuar në të dhënat dytësore, si: raporte të vlerësimit të nevojave të OSHC-ve; raporte të mediave;

raporte progresi të përgatitura nga donatorët; nga organizatat ndërkombëtare, nga agjenci kombëtare – me qëllim identifikimin e zbatimit të legjislacionit në vend.

Dërgimit të kërkesave zyrtare për informacion nga institucionet publike – Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare publike, Partnerët Shqipëri u dërgoi një kërkesë zyrtare të gjitha ministrive në Shqipëri duke kërkuar informacion mbi konsultimet publike me OSHC-të dhe mbështetjen financiare dhe jo financiare ndaj OSHC-ve.

Partnerët Shqipëri i dërgoi kërkesë zyrtare Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për numrin e organizatave të regjistruara gjatë vitit 2016 dhe Kuvendit të Shqipërisë për numrin e projektligjeve, të cilat janë konsultuar me përfaqësues të OSHCve.

2. Vëzhgimi

Vëzhgimi u realizua përmes përdorimit të një pyetësori me 96 OSHC në 14 bashki. Pyetësori u administruar përmes intervistave me telefon dhe postës elektronike me drejtorët ekzekutivë dhe menaxherët e nivelit të lartë të OSHC-ve, gjatë muajit Tetor – Nëntor 2016. Pyetësori ishte i ndarë në katër sesione kryesore: një sesion për të dhënat demografike të OSHC-së dhe të intervistuarit/ës dhe nga një sesion për secilën fushë të Matricës së Monitorimit: garancitë themelore juridike, qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve dhe marrëdhëniet Shtet - OSHC. Pyetësori gjysëm i strukturuar u kombinua me pyetje të hapura dhe të mbyllura me qëllim mbledhjen e informacionit mbi perceptimin dhe përvojën e të intervistuarve mbi indikatorët e monitoruar. Informacioni i

mbledhur nga pyetësorët u përpunua dhe analizua përmes programit SPSS dhe excel.

Partnerët Shqipëri pas përpunimit të të dhënave, realizoi intervista të hollësishme dhe konsultime me përfaqësues të OSHC-ve me qëllim diskutimin e gjetjeve dhe thellim të mëtejshëm të informacionit të dhënë në studim.

Pjesëmarrja e komunitetit të OSHC-ve


Partnerët Shqipëri përdori bazën e saj të të

dhënave të OSHC-ve për të informuar dhe ftuar OSHC-të të marrin pjesë në përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit 2016.

Vëzhgimi u realizua me OSHC-të në 14 bashki. Përzgjedhja e OSHC-ve u bazua në një metodë jo-propabilitare e kombinuar me kampionim të qëllimshëm dhe të përshtatshëm.


Grafiku 1 paraqet shpërndarjen gjeografike të organizatave pjesëmarrëse në studim.

Grafiku 1. Harta e shpërndarjes së OSHC-ve të intervistuar.



Për sa i përket formës ligjore të regjistrimit, 63% shoqata, 27% qendra, 9% fondacione, dhe 1% formë tjetër⁶.

Grafiku 2. Forma e regjistrimit të OSHC-ve të intervistuar.




6) Formë tjetër konsiston në grupe individësh të cilët nuk janë të regjistruar si OSHC (Këshilli Rinor Rajonal Kukës).

Bazuar në përgjigjet e pyetjeve me disa alternativa, në Grafikon 3 janë paraqitur fushat e veprimtarisë dhe aktivitetet kryesore të OSHC-ve të intervistuar në vitin 2016. Siç shihet në grafik ka një dominim të OSHC-ve që punojnë me të rinjtë dhe fëmijët (60% e OSHC-ve), ndjekur nga OSHC-të që punojnë në fushën e të drejtave dhe programeve të mirëqeverisjes (43%). Lidhur me

veprimtarinë kryesore të OSHC-ve në 2016, janë 21% e OSHC-ve të intervistuar që punojnë me të rinjtë dhe fëmijët, ndjekur nga mirëqeverisja me 17% e OSHC-ve dhe mjedisi me 15% e OSHC-ve të intervistuar. Informimi, komunikimi, media, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe Integrimi Evropian nuk janë zgjedhur nga asnjë OSHC si fusha kryesore të veprimtarisë në vitin 2016.

Grafiku 3. Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve të intervistuar



1. Mësimet e nxjerra


- Pyetori i rishikuar i cili u përdor për mbledhjen e të dhënave me OSHC-të, ishte më i gjatë se vitet e kaluara. Pyetësi i përditësuar ndihmoi për mbledhjen e të dhënave cilësore më të detajuara për matjen e indikatorëve të praktikës të matjes, por e zgjati dhe e ndërlikoi paksa procesin e intervistimit dhe përgjigjeve nga OSHC-të.
- Përsëri u konfirmua rëndësia e validimit të informacionit me menaxheret e nivelit të lartë të OSHC-ve, që u zhvillua në fazën e dytë me anën e intervistave të thelluara për rastet e informacionit të paqartë, për të prezantuar një situatë reale të matjes së indikatorëve të matjes.

IV. Gjetjet dhe Rekomandimet

Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive

Nën-fusha 1.1.: Liria e Organizimit

Standarti 1: Të gjithë individët dhe subjektet juridike mund të themelojnë, t'i bashkohen apo të marrin pjesë lirish në organizata jo-formale apo të regjistruara, offline dhe online



Legjislacioni:

Kuadri ligjor për krijimin dhe pjesëmarrjen në OSHC nuk ishte subjekt i ndryshimeve në vitin 2016. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Organizatat Jofitimprurëse" dhe Ligji "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" janë ligjet bazë që rregullojnë krijimin dhe regjistrimin e OSHC-ve në Shqipëri.

Liria e organizimit është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ligje të tjera dhe ushtrohet lirish nga individët dhe subjektet ligjore, të cilët mund të krijojnë dhe marrin pjesë lirish në organizata. Këtë liri e ka çdo individ pa diskriminim kombësie, gjinie, moshe, etj.

OSHC-të mund të krijojnë lirish dhe/apo t'i bashkohen rrjeteve online dhe offline, brenda dhe jashtë vendit pa njoftuar paraprakisht autoritetet shtetërore, dhe mund të përdorin lirish internetin, median sociale dhe platformat online për të informuar publikun pa ndërhyrje nga ana e shtetit.

Regjistrimi dhe ri-regjistrimi i të gjitha OSHC-ve në Shqipëri bëhet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, duke e bërë në këtë mënyrë procesin e regjistrimit të centralizuar dhe të kushtueshëm (shpenzimet noteriale, avokat, transport dhe kohë). Vendimet për ndryshime në aktin e themelimit, të cilat ndikojnë në emër, simbol, objekt, qëllim, fushën e veprimtarisë së orgnizatave jofitimprurës, si dhe vendimet mbi transformimin e saj në një tjetër formë organizate jofitimprurëse duhet të paraqiten në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit⁷.

Kuadri ligjor përcakton që organizata mund të zgjedhë vetë të shpërbëhet ose me një Vendim Gjykatë. Në rastin e fundit, gjykata mund ta shpërbëjë aktivitetin e OSHC-se bazuar në kërkesën e anëtarëve të OSHC-së, organeve vendim-marrëse të OSHC-së, dhe kur veprimtaria

7) Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, për "Organizatrat Jofitimprurëse", neni 16

e OSHC-së është në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, në rastet kur organizata ushtron aktivitet të pa ligjshëm, ka falimentuar dhe kur OSHC-ja nuk është krijuar në përputhje me kuadrin ligjor.

Praktika:


Në përgjithësi, liria e organizimit ushtrohet lirisht nga individët dhe subjektet ligjore të cilët mund të krijojnë dhe marrin pjesë lirisht në organizata. Regjistrimi nuk është i detyrueshëm, dhe praktika tregon se ka shembuj të grupeve informale, të cilët nuk janë të regjistruar, por janë shumë aktiv, të tillë si Këshilli Rinor Rajonal i Kukësit.

OSHC-të e intervistuar, të cilat janë regjistruar midis muajve dhjetor 2015 dhe shtator 2016 (7 nga 96 OSHC të intervistuar) e konsiderojnë procesin e regjistrimit të lehtë dhe kërkesat administrative

jo të vështira. Çështje problematike mbetet kohëzgjatja e regjistrimit, e cila varion nga 25 ditë deri në dy muaj, më gjatë se afati 15 ditor i kërkuar nga ligji. Kosto për regjistrimin, e cila varion nga 7,000 lekë (rreth 50 EUR) deri në 30,000 lekë (rreth 220 EUR), mbeten një nga sfidat kryesore të raportuara nga këto organizata.

Është inkurajues fakti që ka një përqindje të lartë të OSHC-ve të intervistuar (77%) të cilat janë regjistruar apo kanë marrë pjesë në të paktën një rrjet kombëtar ose ndërkombëtar gjatë vitit 2016. Siç është paraqitur në grafikun e mëposhtëm (Grafiku 4) pjesa më e madhe e organizatave kanë patur një proces regjistrimi të lehtë, dhe pjesëmarrje të lehtë në rrjete, pa kërkesa të zgjatura dhe burokratike.

Grafiku 4. Regjistrimi dhe Pjesëmarrja në një Rrjet të OSHC-ve të intervistuar




Vetëm pak organizata (3%) e konsiderojnë që është e vështirë për të marrë pjesë në një rrjet për shkak të rregullave dhe procedurave të vështira që aplikohen nga rrjeti, bazuar në eksperimentin e tyre.

Standarti 2: OSHC-të veprojnë lirisht pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme

Legjislacioni:

OSHC-të janë të pavarura nga shteti dhe Ligji "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"⁸ përcakton që OSHC-të mund të veprojnë lirisht pa ndërhyrje të shtetit në qeverisjen e brendshme dhe në aktivitetet e tyre.



8) Ligji nr. 8789 datë 7.5.2001, "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", Neni 7.

9) Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

10) Ligji nr. 112/2015, datë 15.10.2015, "Për Inspektimin Financiar Publik", Fletorja Zyrtare 186/2015

Rregullat për raportimet financiare për OSHC-të në Shqipëri janë të përcaktuara në Ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"⁹, Ligjin për "Inspektimin Financiar Publik"¹⁰, Udhëzimin për "Mbikqyrjen e OJF-ve nga Organatet Tatimore, në Funkcion të Parandalimit të Parave dhe financimit të Terrorizmit nga Autoritetet"¹¹ dhe të Udhëzimit për "Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Sektorin Jofitimprurës"¹².

Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, i cili hyri në fuqi në Janar 2016, prezantoi procedura të qarta dhe të lehta për raportimin financiar e rregullat e kontabilitetit për tu ndjekur nga OSHC-të në përputhje me madhësinë dhe llojin e organizatës. Standardi gjithashtu i mundëson OSHC-ve formate standarde për raportimin. Organizatat aktive duhet të dorëzojnë pasqyrat vjetore financiare pranë autoriteteve tatimore nëpërmjet sistemit on-line deri më 31 Maj të vitit pasues.

Praktika:

Në nivel praktik, vetëm 8 nga 96 OSHC të intervistuar u shprehën që janë përballur më ndërhyrje nga shteti nëpërmjet presionit/veprimeve të paligjshme në çështjet e tyre të brendshme. Format e presionit/ndërhyrjes së shtetit përfshijnë:

1. Kufizime të pajustificuara lidhur me veprimtarinë e organizatës;
2. Sulm jo legjitim mbi organizatën;
3. Kontrollë në mjediset e organizatës me njoftim paraprak, por të tepërta.

OSHC-të të cilat kanë shprehur këto forma presioni/ndërhyrjen të paligjshme të shtetit janë kryesisht organizata "watchdog" që publikojnë dhe nxjerrin në pah praktikën korruptive të zyrtarëve të zgjedhur apo të nëpunësve publik. Shembull i BIRN Albania, një organizatë mediatike, e specializuar në raportimin investigativ, publikimin dhe monitorimin e medias, e cila është përballur me presione dhe sulme nga nëpunës shtetëror dhe zyrtarë të zgjedhur për të mos publikuar rastet e identifikuar korruptive.

Pothuajse gjysma e OSHC-ve të intervistuar (43%) i konsiderojnë kërkesat raportuese dhe financiare të aplikuara nga shteti të lehta dhe

të qarta, dhe 39% e OSHC-ve të intervistuar i konsiderojnë këto kërkesa në përputhje me madhësinë dhe llojin e organizatës.

Në lidhje me sanksionet e marra gjatë vitit 2016, 15% e OSHC-ve të intervistuar shprehën se kanë qënë subjekt i të paktën një sanksioni. Pjesa më e madhe e sanksioneve janë si rezultat i vonësve të deklarimeve pranë autoriteteve tatimore dhe tek zyra e punës. Një problematikë që haset shpesh nga organizatat lidhet me sistemin online të deklarimit të taksave. Megjithatë këto organizata kanë paguar dhe deklaruar në kohë tek autoritetet tatimore, ato kanë qënë subjekt i gjobave, pasi sistemi nuk i ka reflektuar këto pagesa. Për disa organizata kjo situatë ka rezultuar problematike pasi i ka përjashtuar ata nga marrja pjesë në thirrje për propozime.


Në krahasim me raportin e MM 2015, është vënë re që ka një përqindje të ngjashme të OSHC-ve të intervistuar, të cilat kanë qënë subjekt i gjobave në dy vite (19% në 2015, dhe 15% në 2016). Arsyet mbeten të njëjta dhe në shumicën e rasteve janë të lidhura me vonesat në deklarimet nga OSHC-të. Pjesa më e madhe e OSHC-ve (78%) i konsiderojnë sanksionet jo në propocion me natyrën e shkeljes.

Të gjitha OSHC-të e intervistuar që kanë qënë subjekt i gjobave kanë informacion lidhur me të drejtën për të apeluar sanksionimin, por vetëm 58,5% prej tyre e kanë ushtruar këtë të drejtë. Arsyet pse 41,5% e OSHC-ve të intervistuar nuk kanë ushtruar të drejtën për të apeluar gjobat e marra lidhet më mungesën e besimit tek organet e apelit.

11) Udhëzim nr. 22, datë 19.11.2014 "Për Mbikqyrjen e OJF-ve nga Organatet Tatimore, në Funkcion të Parandalimit të Parave dhe financimit të Terrorizmit nga Autoritetet"

12) Udhëzimi nr.62, datë 17.09.2015 "Për shpalljen e Standartit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve dhe zbatimin e detyrueshëm të tij", nxjerrë nga Ministria e Financave.


Standarti 3: OSHC-të marrin dhe sigurojnë të ardhura financiare nga burime brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur aktivitetin e tyre.



Legjislacioni:

Ligji "Për Organizatat Jofitimprurëse"¹³, nuk paraqet pengesa për OSHC-të për të siguruar burime financiare, qofshin ato me origjinë vendase apo të huaj. Burimet e të ardhurave janë nga kuotat a anëtarësisë, grante, aktiviteti ekonomik, dhurime individuale dhe dhurime nga biznesi. Aktiviteti ekonomik duhet të jetë i lidhur me misionin dhe qëllimin e organizatës dhe nuk lejohet asnjë formë shpërndarjesh të të ardhurave tek personat të cilët janë subjekt i aktit të themelimit ose statutit, përveç detyrimeve në formë rroge, pagese, shpërblimi, rimbursimi dhe

Grafiku 5. Burimi i fondeve për OSHC-të e intervistuar



¹³⁾ Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, për "Organizatrat Jofitimprurëse", i ndryshuar, Neni 38
¹⁴⁾ Ibid, Neni 35


kompesimi që rrjedh nga kontrata e punës apo nga një kontratë tjetër e ngjashme me të¹⁴.

Legjislacioni nuk limiton lirinë e OSHC-ve për të kërkuar dhe siguruar burime financiare nga burime të huaja dhe private. Ligji "Për Organizatat Jofitimprurëse" lejon OSHC-të të marrin fonde nga individë, biznese dhe burime të tjera, duke përfshirë këtu personin juridik dhe tregëtar, fondacionet apo subjektet e tjera ligjore, agjencitë, etj. Dhurimet e kushtëzuara nuk janë të përmendura si një burim të ardhurash në kuadrin ligjor për OSHC-të.

Praktika:

Ndonëse OSHC-të mund të kërkojnë fonde lirisht nga burime të ndryshme, në praktikë ato nuk e përdorin këtë mundësi në shkallë të gjerë. Duke e krahasuar me vitet e kaluara, situata mbetet e njëjtë me donatorët e huaj, të cilët mbeten burimi kryesor i fondeve për OSHC-të e intervistuar, dhe burimi i vetëm për 30% të OSHC-ve të intervistuar. Mesatarisht, siç është paraqitur në Grafikon 6, fondet nga donatorët përbëjnë 64% të totalit të buxhetit për OSHC-të e intervistuar, me një diferencë të konsiderueshme me burimet e tjera të cilat mbeten në nivele të ulta. Të gjitha OSHC-të e intervistuar që kanë marrë fonde nga donator të huaj në vitin 2016 deklaruan se nuk janë përballur me asnjë sfidë nga shteti kur kanë marrë këto fonde.

Grafiku 6. Pesha e çdo burimi të fondeve në buxhetin total të OSHC-ve të intervistuar



Fondet publike, sikurse edhe në raportet e tjera të MM, mbeten një burim i papërfillshëm fondesh. Siç është paraqitur në Grafikon 5, vetëm 14% e OSHC-ve të intervistuar kanë marrë fonde publike në 2016 dhe vetëm 7% e tyre kanë marrë fonde nga pushteti vendor. Siç është paraqitur në Grafikon 6, fondet publike përbëjnë vetëm 4% të financimit total për OSHC-të e intervistuar dhe fondet nga pushteti vendor përbëjnë vetëm 2%. Asnjë nga OSHC-të e intervistuar nuk ka përdorur investimet pasive apo dhurimet e kushtëzuara si burime financimi.

Të ardhurat nga aktiviteti ekonomik janë të limituara deri në 14% të OSHC-ve të intervistuar, sikurse është paraqitur në Grafikon 5, dhe pesha e këtyre fitimeve në totalin e financimeve për OSHC-të e intervistuar është një mesatare prej 5%, sikurse është paraqitur në Grafikon 6. Organizatat që

mundohen të gjenerojnë të ardhura nga aktiviteti ekonomik përballen me disa sfida, të tilla si:

1. Kërkesa të zgjatura administrative;
2. Mundësi të limituara në kapacitete dhe njohuri për t'u angazhuar në aktivitete ekonomike;
3. Trajtim i komplikuar/i rënduar fiskal.

Financimet nga dhurimet e individëve dhe korporatave janë gjithashtu në nivele të limituara për OSHC-të. 31% e OSHC-ve të intervistuar kanë përfituar fonde nga dhurimet individuale (17%) dhe nga dhurimet e korporatave (14%) në 2016. Mesatarisht, këto dhurime përbëjnë vetëm 12% të financimit total të OSHC-ve të intervistuar. Procedurat për përfitimin e dhurimeve nga individë dhe korporata janë konsideruar në përgjithësi të lehta, pa kosto të panevojshme apo barrë administrative për OSHC-të.

Nën-fusha 1.1., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve që vijnë më poshtë të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e Shoqërisë Civile 2014 – 2020

1.1.a. Vlerësimi i cilësisë së legjislacionit ekzistues dhe kuadrin ligjor

- Të gjitha mangësitë në legjislacionin kombëtar dhe kuadrin ligjor në lidhje me regjistrimin e OSHC-ve janë të identifikuar
- Procedura të gjata regjistrimi nga 25 ditë deri në 2 muaj, duke e tejkaluar periudhën prej 15 ditësh, si periudha maksimale e vendosur nga ligji.
- Centralizimi i regjistrimit dhe ri-regjistrimit, dhe kosto e lartë e regjistrimit (50 – 220 EUR) mbeten disa nga sfidat për tu përmirësuar në legjislacionin ekzistues për regjistrimin e OSHC-ve.

1.b. Progresi i adaptimit dhe zbatimit të legjislacionit përkatës

- Nuk ka progress mbi adaptimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës në lidhje me regjistrimin, ndërprerjen dhe shpërbërjen e OSHC-ve.

1.3.a. Cilësia e mjedisit mundësues për organizatat me bazë komunitare (grass roots organisations)

Organizatrat me bazë komunitare nuk njihen si një lloj i veçantë OSHC në kuadrin ligjor në Shqipëri, ndaj nuk ka politika të veçanta dhe rregulla të aplikuara për këtë lloj organizatash. Mjedis ekzistues për zhvillim e OSHC-ve ndikon në mënyrë të barabartë të gjithë OSHC-të

2.1.a. Perceptimi i OSHC-ve për lehtësirat dhe efikasitetin e rregullave financiare dhe kërkesave raportuese (të ndara sipas llojit/madhësisë së OSHC-ve)


Në 2016, Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse prezantoi lehtësirat në rregullat financiare dhe kërkesat raportuese për OSHC-të. Perceptimi i 82% i OSHC-ve të intervistuar është se kërkesat dhe raportimet financiare janë të lehta, të qarta dhe në përpjestim me madhësinë dhe llojin e organizatës.

2.1.b. Vlerësimi i cilësisë së rregullave financiare (me fokusin në krijimin e mekanizmave që rregullon ndryshimin e rregullave financiare dhe detyrimevekur fitimet dhe aktivitetet jo-komerciale ndryshojnë)

- Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse prezanton në mënyrë të thjeshtëzuar rregullat dhe kërkesat e raportimit për organizatat me të ardhura vjetore nën 5 milion lekë (rreth 35,700 EUR).

Nën-fusha 1.2 Liritë e tjera

Standarti 1: Përfaqësuesit e OSHC-ve në mënyrë individuale, apo nëpërmjet organizatës së tyre, gëzojnë lirinë e organizimit paqësor.



Legjislacioni:

Kuadri ligjor në Shqipëri garanton të drejtën e lirisë së organizimit, sikurse është përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë¹⁵ dhe e specifikuar në Ligjin "Mbi Tubimin"¹⁶. Ky ligj është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe mundëson të drejtën e lirisë së organizimit për të gjithë, individët dhe entitetet juridike, pa diskriminim. Çdo qytetar ka të drejtën të organizojë dhe/ose të marrë pjesë në një organizim paqësor dhe jo të armatosur.

Tubimet në hapsirat publike mund të organizohen pa njoftime paraprake në polici. Për rastet kur ligji përcakton njoftim paraprak për tubime të organizuara në hapsirat publike dhe kalime publike, procedurat janë të qarta dhe jo të rënduara për ata që dëshirojnë të zhvillojnë një tubim.

Ligji mbi tubimin përcakton që në rastet e kufizimeve të një tubimi, organizatorët kanë të drejtën të apelojnë¹⁷ vendimet e lëshuara nga autoritetet për kufizimin e tubimit.

¹⁵⁾ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 46 & 47

¹⁶⁾ Ligji Nr. 8778, datë 23.04.2001 "Për Tubimet"


¹⁷⁾ Ibid, Article 25

Praktika:

52% e OSHC-ve të intervistuar kanë marrë pjesë në të paktën një tubim të organizuar në 2016, dhe 18% kanë qenë gjithashtu edhe organizatorë të tubimit. Shumica e OSHC-ve, të cilat kanë organizuar ose kanë marrë pjesë në një tubim (86%) vlerësuan se nuk janë përballur me asnjë sfidë gjatë organizimit apo pjesëmarrjes në një tubim paqësor.

Tubime sponatane janë organizuar nga 24% e OSHC-ve, pa njoftim paraprak tek autoritetet shtetërore. Nuk ka asnjë rast nga OSHC-të e intervistuar për ndërhyrjen nga policia e shtetit gjatë tubimit.

Standarti 2: Përfaqësuesit e OSHC-ve, individualisht apo nëpërmjet organizatës së tyre gëzojnë lirinë e shprehje



Legjislacioni:

Liria e shprehjes është një e drejtë themelore dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligje të tjera përkatëse janë në linjë me kuadrin ligjor ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, duke garantuar liritë individuale ku përfshihet liria e privatësisë, liria e shprehjes dhe sanksione kundrejt nxitjes së urrejtjes. Liria e shprehjes është një e drejtë kushtetuese.¹⁸ Kodit penal rregullon shpifjen e cila denohet me gjobë.

Praktika:

Në nivelin praktik, sikurse është paraqitur nga eksperiencia e OSHC-ve të intervistuar, liria e shprehjes respektohet. OSHC-të e intervistuar nuk kanë përjetuar presion të paligjshëm për shprehjen e kritikave kundrejt autoriteteve shtetërore, ndjekje penale për fjalime kritike, apo kërcënime për pikëpamje të ndryshme. Asnjë nga OSHC-të nuk ka përjetuar bllokim të komunikimit online.

Vlerësimi i Standartit 1, të Nën-fushës 1.2., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve që vijojnë më poshtë të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e Shoqërisë Civile 2014-2020. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin tregues janë:

1.1.b. Vlerësimi i cilësisë për legjislacionin ekzistues dhe kuadrin ligjor


- Legjislacioni ekzistues dhe kuadri ligjor garantojnë të drejtat e lirisë, shprehjes, tubimit dhe organizimit për të gjithë individët dhe subjektet ligjore. Ata që kërkojnë të mbledhen nuk janë të detyruar të kenë leje për tu mbledhur në bazë të Ligjit mbi Tubimin. Në përputhje me standartet ndërkombëtare, legjislacioni kërkon të paraqitet tek autoritetet shtetërore vetëm një letër njoftimi për të ushtruar lirinë e organizimit.

1.1.c. Progresi në adaptimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës

- Nuk ka ndryshime në kuadrin ligjor për ushtrimin e lirisë, shprehjes, tubimit dhe organizimit. Në praktikë, nuk ka raste të raportuara nga OSHC-të e intervistuar mbi presionin e paligjshëm për shprehjen e kritikave kundrejt autoriteteve shtetërore, ndjekje penale për fjalime kritike, apo kërcënime për pikëpamje të ndryshme.

¹⁸⁾ Neni 22

Standarti 3: Përfaqësues të shoqërisë civile, individualisht apo nëpërmjet organizatave të tyre, në mënyrë të sigurtë kanë të drejtën për të marrë dhe dhënë informacion nëpërmjet të gjitha llojeve të medias



Legjislacioni:

Kuadri ligjor nuk imponon asnjë kufizim mbi përdorimin e internetit dhe platformave online. Nuk ndalon komunikimin dhe nuk kufizon aksesin ndaj burimeve të ndryshme të informacionit dhe shteti nuk vendos kufizime mbi përdorimin e internetit¹⁹.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë përcakton garancitë specifike kundër përdorimit të paligjshëm të monitorimit të kanaleve të komunikimit dhe grumbullimit të informacionit për përdoruesin.

Praktika:


Shkëmbimi i informacionit respektohet nga autoritetet shtetërore. Asnjë nga OSHC-të e intervistuar nuk ka raportuar ndonjë lloj interference nga autoritetet shtetërore, si bllokimin e platformave online, monitorim të paligjshëm të komunikimit apo ndëshkim për përkatësinë tek një rrjet social.

19) <https://freedomhouse.org/country/albania>

Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të

Nën-fusha 2.1 Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre

Standarti 1: Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ndryshme të ardhurash të OSHC-ve



Legjislacioni:

Nuk ka ndryshime në kuadrin ligjor fiskal që ndikojnë OSHC-të për periudhën që mbulon ky raport. Legjislacioni fiskal që adreson aktivitetin e OSHC-ve përfshin:

1. Ligjin Nr. 99/2015, datë 23.9.2015 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
2. Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.7.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
3. Udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë"
4. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"

Bazuar në Ligjin mbi procedurat Tatimore, neni 40, të gjitha organizatat jofitimprurëse të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, duhen të regjistrohen tek administrata tatimore dhe të tërheqin Numrin e Identifikimit të Personit të Tatushem (NIPT) që shërben si numri i identifikimit tatimor, për taksat kombëtare dhe lokale. Përveç

kësaj, organizatat duhet të njoftojnë administratën tatimore, brenda 15 ditëve nga regjistrimi për ndryshime në gjykatë, për çdo nga ndryshimet e mëposhtme: (a) emri; (b) adresa; (c) statusi ligjor; (d) themelimi/shpërbërja e degëve; (e) ndryshimi i llojit të aktivitetit ekonomik; (f) dhe çdo ndryshim tjetër, të përshkruar në aktet ligjore lidhur me këtë ligj. Nëse këto kërkesa ligjore nuk përmbushen nga organizatat, një gjobë prej 10,000 lekë (rreth 75 EUR) do të aplikohet nga administrata tatimore.

Nëse një organizatë nuk ushtron asnjë aktivitet për një periudhë tatimore prej 12 muajve rradhazi, apo nuk paraqet deklarimet tatimore për një periudhë prej 12 muajve rradhazi, apo deklaron pezullimin e aktiviteteve të tij, do të transferohet nga administrata tatimore tek regjistri pasiv i tatimpaguesve. Gjatë statusit pasiv, organizata nuk ka detyrim të paraqes deklarimet tatimore dhe nuk aplikohen gjoba për mosdeklarim. Administrata tatimore duhet të njoftojë organizatën për këtë kalim brenda 10 ditëve, nga dita që është kryer kalimi.

Ligji i ri për TVSH, i cili hyri në fuqi në 1 Janar 2015, dhe aktet ligjore të lidhura me të kanë bërë disa sqarime lidhur me përjashtimin e TVSH-së për OSHC-të. Ligji për TVSH-në dhe Udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" përcakton që për fondet, grantet, tarifën e anëtarësimit për OSHC-të nuk aplikohet TVSH kur pagesa të tilla janë kryer në përputhje me Ligjin Për Organizatat Jofitimprurëse dhe kur OSHC-të nuk furnizojnë donatorët me të mira apo shërbime si kundërvlerë, por e përdorin pagesën e marrë për të përmbushur qëllimin e aktivitetit të tyre jofitimprurës.

Organizatat që nuk i përmbushin kriteret për regjistrimin në TVSH, por që janë të regjistruara automatikisht nga autoritetet e taksave për TVSH-në, duhet të paraqesin një kërkesë të autoritetet e taksave për t'u çregjistruar nga TVSH-ja. Në rastin kur një organizatë ushtron aktivitet ekonomik për të gjeneruar të ardhura, të cilat përdoren nga organizata për të përmbushur misionin e saj, atëherë organizata konsiderohet një entitet i tatushëm dhe duhet të regjistrohet për TVSH, pavarësisht qëllimit të aktivitetit ekonomik.

20) Ligji nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë"

21) Vendim Nr. 953, datë 29.12.2014, "Për Dispozitat Zbatuese Të Ligjit Nr. 92/2014, "Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 2

22) Udhëzim nr. 6, datë 30.1.2015, "PËR TVSH-NË", neni 63, pika 4

23) Ligji nr.92/2013, Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin 8788, datë 07.5.2001, "Për Organizatat Jofitimprurëse", të Ndryshuar, neni 40.

Përjashtim bëjnë rastet kur aktivitete të tilla janë të përjashtuara nga TVSH-ja nga Ligji Për tatimin mbi vlerën e shtuar²⁰ e detajuar më tej nga një vendim i Këshillit të Ministrave²¹.

Organizatat duhet të paraqesin deklarimet e TVSH në kohën dhe sipas formateve të përshkruar nga ligji, edhe në rastet kur ata kanë përfituar nga përjashtimi i TVSH. Si çdo tatimpagues tjetër, edhe organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të kërkojnë rimbursimin e TVSH, nëse përmbushin kriterin e përshkruar në Nenin 77 të Ligjit mbi TVSH, dhe duke ndjekur procedurat e përshkruara në Udhëzuesin nr.6, datë 30.01.2015, "Mbi TVSH" Udhëzuesi sqaron gjithashtu procedurën e rimbursimit të TVSH për projektet e financuara nga IPA, në kuadër të Ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian për Rregullat e Bashkëpunimit për Asistencën për Shqipërinë"²². Taksat mbi interesin për depozitat bankare, si një nga format e investimeve pasive, përjashtohet nga tatimi mbi të ardhurat²³. Dhurimet e kushtëzuara nuk janë të rregulluara me ligj, për këtë arsye nuk ka përfitime tatimore për burime të tilla të të ardhurave të OSHC-të.

Praktika:

Sqarimet në ligjin e ri të TVSH mbi përjashtimin për grantet, është shoqëruar me një sqarim më të gjerë nga OSHC-të, të cilët nuk raportojnë më aplikimin e taksave (direkte apo të fshehura) mbi grantet. Praktika gjithashtu tregon se shumë OSHC janë të regjistruara në skemën e TVSH, pavarësisht faktit që ato nuk duhet të jenë të regjistruara, ndaj duhet të ndjekin procedurat e vendosura në Ligjin e TVSH-së (sikurse është përshkruar në sesionin e mëparshëm), për t'u çregjistruar.

Sikurse u përmend në sesionet e mëparshme, janë vetëm 13 OSHC, të cilat përdorin aktivitetin ekonomik si një burim të ardhurash për aktivitetin e tyre. Kur u pyetën mbi përjashtimin e TVSH-së për aktivitetin e tyre ekonomik, u vu re një konfuzion nga pjesa më e madhe e OSHC-ve të intervistuar mbi aplikimin e këtij përjashtimi dhe mbi procedurat që duhen ndjekur, për ta përfituar. Gjashtë (6)

OSHC deklaruar se aktiviteti i tyre ekonomik është automatikisht i përjashtuar nga dispozita në Ligjin për TVSH dhe aktet ligjore përkatëse, ndërsa shtatë (7) OSHC nuk kanë aplikuar për përjashtim nga TVSH-ja, për shkak të mungesës së besimit në institucionet shtetërore që aprovojnë përjashtimin e TVSH-së dhe për shkak të eksperiencave negative të organizatave të tjera që kanë aplikuar për përjashtimin nga TVSH-ja.


Praktika tregon, se në mënyrë të ngjashme si vitin e kaluar, përforsimi dhe qartësimi i rimbursimit të TVSH-së për projektet IPA nëpërmjet një udhëzimi nga Ministri i Financave, nuk ka kontribuar në një zbatim më të mirë dhe korrekt të marrëveshjes midis qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian, pasi asnjë nga organizatat nuk ka përfutur nga rimbursimi i TVSH për projektet e IPA.

Një tjetër çështje problematike që lidhet me rimbursimin e TVSH mbetet rimbursimi i fondeve për programet e tjera të financuara nga BE nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri ose në nivel ndërkombëtar, pasi nuk janë të përfshira në marrëveshjen e sipërpërmendur mes Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian. Kjo është një barrë e konsiderueshme financiare për OSHC-të përfituese dhe nga ana tjetër ndalon OSHC-të shqiptare të marrin pjesë në këto programe.

Sikurse është adresuar në Raportin e MM 2015, ka ende kërkesa nga disa donatorë për lëshimin e faturave me TVSH për grantet e financuar prej tyre, në kundërshtim me Ligjin e TVSH-së.

Studimi me OSHC-të tregon mungesë të njohurive nga administrata tatimore lidhur me ndryshimet ligjore. Nga ana tjetër, studimi tregon mungesë të informacionit, dhe të të kuptuarit të kuadrit fiskal nga OSHC-të, duke rezultuar në marrjen e gjobave.

Standarti 2: Ofrohen lehtësira për të nxitur dhurimet nga individë dhe korporata



Legjislacioni:


Mjedisi ligjor që rregullon dhurimet nuk ka qënë subjekt ndryshimi gjatë vitit 2016. Incentivat fiskale nuk mbështesin dhurimet e individëve dhe korporatave. Ligji kryesor, i cili rregullon dhurimet është Ligji për Sponsorizimet²⁴. Shuma e sponsorizimit njihet si një shpenzim i zbritshëm nga 3% deri në 5% e fitimit para tatimit. Zbritja aplikohet nga autoritetet shtetërore bazuar në kontaktin e sponsorizimit dhe provat për ushtrimin e sponsorizimit. Dhurimet individuale nuk njihen nga ligji Për Sponsorizimet, kështu janë të përjashtuara nga përfitimet e ligjit.

Në ato pak dokumenta politikash lidhur me Përgjegjësinë Sociale të Korporatave (PSK), si Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve dhe Planit i Veprimit për vitin 2014 -2020, OSHC-të nuk konsiderohen si një partner kyç dhe përfituesit e PSK. Si rrjedhojë, nevojat e OSHC-ve nuk adresohen.

Praktika:

Nga monitorimi i aktivitetit filantropik në Shqipëri i realizuar nga Partnerët Shqipëri, është vënë re një rritje në numrin e dhurimeve, nga 217 në vitin 2015 në 465 në vitin 2016. Për periudhën Dhjetor 2015 – Shtator 2016, numri më i lartë i dhurimeve, 55% e dhurimeve, është kryer nga individë.

Grafiku 8. Dhurimet sipas natyrës së donatorëve



Gjetjet gjithashtu tregojnë që donatorët përdorin OSHC-të ose Institucionet Publike për të kanalizuar dhurimet e tyre, shpesh në rastet kur ata dëshirojnë të qëndrojnë anonim ose kur ata nuk mund të shkojnë direkt tek përfituesi përfundimtar. Në periudhën Dhjetor 2015 – Shtator 2016, rreth 35% e dhurimeve janë kanalizuar nëpërmjet OSHC-ve.

OSHC-të e intervistuar theksuan çështjet e mëposhtme si sfidat kryesore për zhvillimin e filantropisë në vend:

1. Mungesa e strategjive publike/politikat që stimulojnë dhurimin filantropik (62%);
2. Kultura e pazhvilluar e dhurimit (53%);
3. Incentivat tatimore që aplikohen nuk janë stimuluese për donatorët (48.3%).

Një studim i ndërmarrë nga Partnerët Shqipëri me 130 kompani private në periudhën Qershor – Shtator 2016²⁵, tregon se për të rritur dhurimet e tyre ndaj OSHC-ve, ndërmarrjet shqiptare do të donin si më poshtë:

- Vlerësimi i Standardit 2, të Nën-fushës 2.1 reflekton gjithashtu vlerësimin e treguesve që vijnë të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e Shoqërisë Civile. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin indikator janë:

2.2.a. Numrin dhe llojin e dhurimeve tek OSHC-të nga individë apo korporata (të specifikuar në vlera monetare)

- Të dhënat nga monitorimi i aktivitetit filantropik në Shqipëri realizuar nga Partnerët Shqipëri tregojnë se janë 147 raste të dhurimeve nga donatorë individë dhe biznese tek OSHC-të me një vlerë prej 12,629,265 lekë (rreth 93,000 EUR) dhe dhurimet në natyrë kryen në mallra dhe produkte (139 raste), me vlerë monetare (7 raste) dhe shërbime (1 rast).

- Hartimi i një kuadri ligjor, i cili rregullon aktivitetin filantropik dhe nxit donatorët (korporatat dhe individët) të dhurojnë tek OSHC-të;
- Kuptimi më i mirë i strategjisë së investimit të biznesit nga OSHC-të;
- Kapaciteti i OSHC-ve për të manaxhuar dhurimet;
- Informacion më lehtë i aksesueshëm dhe i disponueshëm mbi fushat e aktivitetit të OSHC-ve;
- Rritje e incentivave fiskale për dhurimet tek OSHC-të.

Gjithashtu, raporti tregon që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet përgjegjësisë sociale të biznesit (PSB) dhe aktivitetit filantropik/ dhurimeve, por ka një numër shumë të vogël të ndërmarrjeve që kanë një dokument strategjik të PSB (15%e rasteve). Në praktikë, ekzistojnë pak iniciativa partneriteti që promovojnë PSB për sektorin e shoqërisë civile.

24) Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Mbi sponsorizimet", i ndryshuar.

26) <http://partnersalbania.org/publication/aktiviteti-filantropik-i-ndermarrjeve-ne-shqiperi-studimi-i-dyte-2016/>

2.2.b. Cilësia dhe zbatueshmëria/praktika e kuadrit ligjor për dhurimet individuale dhe të korporatave

-Ligji Për Sponsorizimin është i vetmi ligj që siguron incentiva tatimore për dhurimet e korporatave. Shuma e sponsorizimit njihet si shpenzim i zbritshëm nga 3% deri në 5% e fitimit para tatimit. Dhurimet nga individët nuk njihen nga ky ligj. Kuadri ligjor nuk është favorizues dhe nuk inkurajon për dhurimet individuale dhe të korporatave.


2.3.a. Cilësia e sistemit të përfitimeve tatimore për aktivitetet operacionale dhe ekonomike të OSHC-ve

- Të ardhurat nga aktiviteti ekonomik që lidhet me misionin e OSHC-ve nuk taksohet nëse ato arrijnë deri në 20% të fitimeve vjetore të OSHC-ve.

- Sistemi i përfitimeve tatimore nuk konsiderohet efektiv për aktivitetin operacionel dhe ekonomik të OSHC-ve. Ndryshimet në ligjin e ri për TVSH-në që hyri në fuqi në vitin 2015 nuk janë zbatuar me efikasitet lidhur me rimbursimin e TVSH-së për projektet e IPA dhe kërkesat e donatorëve për lëshimin e faturave me TVSH për grantet.

Nën-fusha 2.2 Mbështetja e shtetit

Standarti 1: Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen e projekteve dhe bashkë-financimin e BE dhe granteve të tjera



Legjislacioni:

Legjislacioni mbi financimin publik nuk ka ndryshuar në vitin 2016. Ligji nr. 10093, datë 9.3.2009, "Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" është dokumenti kryesor që rregullon mbështetjen e shtetit ndaj OSHC-ve. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është mekanizmi kryesor me mandat për të shpërndarë fondet publike për

zhvillim institucional, mbështetje të projekteve dhe bashkë-financim të granteve të BE dhe donatorëve të tjerë. Çdo vit alokohet një shumë e ngjashme nga buxheti i shtetit për Agjencinë.

Pjesëmarrja e OSHC-ve në ciklin e financimit publik sigurohet vetëm nëpërmjet përfaqësimit të me pesë anëtarë në Bordin Mbikëqyrës të AMSHC, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave.

Përfaqësim më i gjerë i OSHC-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik nuk përcaktohet në legjislacionin që rregullon funksionimin e AMSHC.

Praktika:

Bazuar nga të dhënat e faqes së saj të internetit, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka shpallur vetëm një thirrje për propozime në periudhën Dhjetor 2015 – Shtator 2016. Kjo thirrje për propozime u shpall në Shkurt 2016 dhe kishte dy komponentë kryesor:

1. Projektet e financuara vetëm nga AMSHC;
2. Projektet e bashkë-financuara nga AMSHC dhe donatorë të tjerë²⁶

Thirrja për propozime adresoi një gamë të gjerë të fushave prioritare, duke përfshirë mjedisin mundësues për shoqërinë civile dhe fuqizimin e rolit të OSHC-ve në reformat dhe iniciativat që përmirësojnë mjedisin mundësues. Megjithatë, nuk ka informacion publik rreth projekteve të financuara sipas këtij prioriteti dhe nuk ka

²⁶⁾ <http://www.amshc.gov.al/web/thirrje/09/>

informacion për të gjitha prioritetet e tjera të adresuara nëpërmjet kësaj thirrjeje për propozime.

Numri total i OSHC-ve fituese ishte 41, me një vlerë totale prej 85,200,000 Lek (rreth 622,000 EUR). Fondi më i vogël ishte 500,000 lek (rreth 3,700 EUR), ndërsa fondi maksimal ishte 5,000,000 Lek (rreth 36,800 EUR).

Ashtu siç është evidentuar edhe në raportet e mëparshme të MM, edhe këtë vit Agjencia nuk ka shpallur asnjë thirrje për mbështetje institucionale për OSHC-të.

Një tjetër burim i fondeve publike për OSHC-të në vitin 2016 ka qënë Ministria e Kulturës. Të dhënat nga faqa zyrtare e Ministrisë së Kulturës tregojnë se ministria ka siguruar fonde në formën e granteve për 52 OSHC nga 92 grante të alokuara në total²⁷. Vlera totale e përfituar nga OSHC-të është 33.084.300 lekë (rreth 246 000 Euro).

Fondi i Llotarisë Kombëtare shpalli thirrjen e dytë për propozime në vitin 2016. Vlera totale e fondeve në dispozicion ishte 7,025,566 lekë (rreth 51,700 EUR) dhe u alokua për financime afat-shkurtra deri në një vit dhe për financime afat-gjata deri në tre vjet²⁸. Bazuar në të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Fondit të Llotarisë Kombëtare, katër OSHC u shpallën fituese. Nuk ka asnjë informacion mbi vlerën e mbështetjes financiare të dhënë për secilin projekt.

Në tetor 2016, PSH dërgoi një kërkesë zyrtare në të gjitha ministritë duke ju kërkuar informacion mbi: (i) vlerën totale të shumës së shpërndarë në 2016 për OSHC-të; (ii) numrin total të organizatave të cilat aplikuan; (iii) numrin total të organizatave që përfituan nga këto fonde; (iv) vlerën minimale dhe maksimale të fondit të shpërndarë; (v) numrin e shërbimeve të prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile; (vi) vlerën totale të kontratave për shërbimet e prokuruar nga organizatat e shoqërisë civile; (vii) numrin e organizatave të shoqërisë civile që kanë përfituar mbështetje jo-financiare; dhe (viii) llojin e mbështetjes jo-financiare.

Ministritë që vijojnë (7 nga 17 ministri) i janë

²⁷⁾ <http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/njoftime/thirrja-per-projekt-propozime-2016-projektet-e-perzgjedhura-per-mbeshtetje&page=3>

²⁹⁾ <http://www.lotaria.al/index.php/sq/kompania/good-causes-2>


përgjigjur kërkesës së PSH mbi mbështetjen financiare dhe jo-financiare të shtetit të ofruar për OSHC-të: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Ministria e Integritimit Evropian, Ministër për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, dhe Ministri i Shtetit për Çështje Vendore.

Bazuar në përgjigjet e tyre, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes deklaroi se ka alokuar dhe shpërndarë fonde publike me një vlerë prej 3,822,690 lekë (rreth 28500 Euro) për 3 OSHC, nga 17 OSHC-të të cilat aplikuan për këtë fond. Ministria e Financave deklaroi se fondet shtetërore të alokuara për OSHC-të kanë një vlerë prej 101 milion lekë të dhëna nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Rezultatet nga studimi me OSHC-të tregojnë se 32% e OSHC-ve të intervistuar kanë aplikuar për mbështetje nga shteti, dhe vetëm 11% e tyre kanë përfituar një financim nga institucionet respektive: Ministria e Kulturës (5 OSHC), AMSHC (3 OSHC), Fondi i Llotarisë Kombëtare (2 OSHC). Sipas 75% të OSHC-ve të intervistuar financimi publik nuk është i mjaftueshëm dhe nuk i përgjigjet nevojave të OSHC-ve.

Duke krahasuar gjetjet në këtë raport me raportet e mëparshme të MM, është e qartë se situata me financimin publik në lidhje me shumën, rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e tyre nuk ka ndryshuar as në nivelin ligjor dhe as në atë praktik. Financimi publik në nivele të kufizuara, të shpërndara vetëm tek një numër i vogël i OSHC-ve, nuk planifikohet në bashkëpunim dhe në përputhje me nevojat e OSHC-ve.

Standarti 2: Financimi Publik jepet në mënyrë të paracaktuar dhe transparente



Legjislacioni:

Ligji për AMSHC-në dhe rregulloret e brendshme përcaktojnë dhe lejojnë një proces transparent të shpërndarjes së fondeve. Njoftimi për procedurën e financimit është publik dhe ofron kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar projekt propozimet dhe të gjithë dokumentat e kërkuara.

Çështja e konfliktit të interesit gjatë vlerësimit të propozimeve adresohet në mënyrë të përgjithshme në ligjin për AMSHC dhe procedurat

e brendshme të Agjencisë, por nuk ka procedura të sakta për mënyrën e shmangies së situatës dhe si bëhet zëvendësimi i anëtarëve të Bordit Mbikqyrës me një tjetër vlerësues të kualifikuar, në raste të konfliktit të interesit.


Ministria e Kulturës dhe Fondi i Llotarisë Ndërkombëtare ndjek të njëjtat procedura në termat e njoftimit për thirrje për propozime për shpërndarjen e fondeve të tyre duke ofruar një shumë minimale dhe maksimale për secilin nga financimet e kërkuara bazuar në periudhën e zbatimit të grantit.

Praktika:


Perceptimi i 45% i OSHC-ve është se kriteret e seleksionimit për shpërndarjen e financimit publik nuk janë të qarta dhe në dispozicion të publikut, dhe OSHC-të nuk marrin pjesë në procesin e vendosjes së prioriteteve për financimin publik.

Nga ana tjetër, 36% e OSHC-ve të intervistuar konsiderojnë se vendimet për shpërndarjen e fondeve publike nuk janë të drejta dhe konflikti i interesit nuk deklarohet më përpara, duke vënë në pikëpyetje transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike mbi vendimet për procedurat e tenderimit.

Grafiku 9. Perceptimi i OSHC-ve të intervistuar mbi financimin publik



Standarti 3: Ka një sistem të qartë të llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimeve publike



Legjislacioni:


Organizatave Shoqërisë Civile që janë të financuara nga qeveria janë subjekt i Ligjit Nr. 112/2015 "Për inspektimin financiar publik"³⁰, që ka për qëllim të garantojë ekzekutimin e legjitimitetit në përdorimin e fondeve publike.

Ligji për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile sëbashku me rregulloret e brendshme të saj, përshkruajnë qartë dhe në detaje procedurat e llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit në mbështetje të një procesi transparent të granteve.

Praktika:

Sikurse është vërejtur në faqen e internetit të AMSHC-së, ka një mungesë të informacionit mbi progresin e projekteve të financuara nga Agjencia. Raporti Vjetor i Agjencisë prezanton të dhëna statistikore dhe informacion mbi projektet e financuara nga Agjencia, por ka një mungesë të informacionit përshkruar mbi rezultatet dhe impaktin e projekteve. Një situatë e ngjashme është edhe me institucionet e tjera që kanë ofruar financime publike për OSHC-të në 2016.

Standarti 4: Ekziston mbështetje jo-financiare nga shteti



Legjislacioni:

Shqipëria nuk ka një ligj apo rregullore të përshtatshme me dispozita të veçanta që autorizojnë autoritetet shtetërore për të siguruar mbështetje jo-financiare për OSHC-të. Kjo është e ndërlidhur me mungesën e një procedure formale dhe transparente për ofrimin e mbështetjes jo-financiare për OSHC-të.

Praktika:

Bazuar në të dhënat e ofruara nga ministritë që iu përgjigjen kërkesës së PSH për informacion, vetëm Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike deklaroi se ka ofruar mbështetje jo-financiare për OSHC-të në 2016, duke ofruar ambientet e Qendrës së Inovacionit pa pagesë për OSHC-të dhe grupet e interesit. Nga hulumtimi me OSHC-të, disa prej tyre kanë raportuar të kenë përdorur hapsirat e lira të vëna në dispozicion nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për të organizuar aktivitetet e tyre.

Mbështetja jo-financiare është më e mundshme për OSHC-të në nivel vendor, pasi 27% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan se kanë përfituar mbështetje jo-financiare nga bashkitë e Durrësit, Pukës, Tiranës dhe Shkodrës në forma të tilla si: ofrimii i hapsirave të lira, automjete dhe materiale zyre për të organizuar aktivitetet e tyre, si dhe ekspertizën e zyrtarëve publikë për zbatimin e aktiviteteve të tyre.

30) Ligji Nr. 112/2015, Për inspektimin financiar publik, neni 4

Vlerësimi i Standardit 2, të Nën-fushës 2.2., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve që vijnë në Udhëzuesin e BE për mbështetjen e Shoqërisë Civile 2014-2020.

Gjetjet bazuar në objektivat për secilin indikator janë:

2.4.a. Perceptimi i OSHC-ve në sigurimin e fondeve në termat e transparencës, të drejtës dhe mosdiskriminimit


Perceptimi i 45% të OSHC-ve të intervistuar është se kriteret e seleksionimit për shpërndarjen e financimeve publike nuk janë të qarta dhe në dispozicion të publikut, 36% e OSHC-ve të intervistuar konsiderojnë se vendimet në shpërndarjen e fondeve publike nuk janë të drejta dhe konflikti i interesit nuk deklarohet në fillim, duke vënë në pikëpyetje transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike mbi vendimet e tyre për tenderat.

2.4.c. Cilësia e kuadrit të financimit shtetëror për organizatat e shoqërisë civile (duke u fokusuar në procedurat dhe dokumentacionin)

- Situata me financimin publik në lidhje me vlerën dhe rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e tyre nuk ka ndryshuar. Financimi publik mbetet në nivele të kufizuara, duke u shpërndarë vetëm një në numër të vogël të OSHC-ve, jo e planifikuar në bashkëpunim dhe në përputhje me nevojat e OSHC-ve.

Nën-fusha 2.3 Burimet njerëzore

Standarti 1: OSHC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë



Legjislacioni:

Kuadri ligjor nuk ofron trajtim ndryshe për OSHC-të si punëdhënësit, duke mos marrë në konsideratë natyrën dhe qëllimin e OSHC-ve.

Pra, ligji i imponon OSHC-të që të regjistrohen

dhe të paguajnë kontributet shoqërore dhe shëndetësore për të paktën një punonjës, duke përfshirë edhe organizatat me baza vullnetare. Ligji për Nxitjen e Punësimit³⁰ i ndryshuar, dhe disa vendime të Këshillit të Ministrave³¹ përcaktojnë politika aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin në të gjithë sektorët, pa referenca specifike për OSHC-të.

Praktika:


Sikurse edhe në raportet e mëparshme të MM, ka ende mungesë të të dhënave zyrtare për numrin e të punësuarve (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, ekspertë) që punojnë në OSHC-të.

Në praktikë, OSHC-të kanë një numër të kufizuar të burimeve njerëzore, sikurse është reflektuar në Grafikët 9 dhe 10 duke treguar situatën me punonjësit e punësuar nga OSHC-të me kohë të plotë dhe më kohë të pjesshme. 15% e tyre nuk kanë asnjë punonjës me kohë të plotë, ndërsa 25% e tyre nuk ka asnjë punonjës me kohë të pjesshme. Më shumë se gjysma e OSHC-ve kanë 1-5 punonjës me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, respektivisht 53% dhe 58%. ARSIS është e vetmja organizatë, e cila ka më shumë se 30 punonjës me kohë të plotë.


30) Ligji nr 7995, Date 20.9.1995, për Nxitjen e Punësimit, i ndryshuar

31) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 27, "Programi për Inkurajimin e punësimit të grave të papuna", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 47, "Programi për Inkurajimin e punësimit nëpërmjet trajnimit në punë" Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 48, "Programi për Inkurajimin e punësimit për punësimin e persona në vështirësi" Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 199, "Programi për Inkurajimin e punësimit të rinjve të papunë" Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 873, "Programi i Praktikave profesionale për të sapodiplomuarit" Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 248, "Programi i promovimit të punësimit për personat me aftësi të kufizuara".

Grafiku 9. Punonjës me kohë të plotë nga OSHC-të e intervistuar.



Grafiku 10. Punonjësit me kohë të pjesshme nga OSHC-të e intervistuar




Kur u pyetën mbi ndonjë përfitim nga programet shtetërore për nxitjen e punësimit, pothuajse të gjitha organizatat e intervistuar u përgjigjën që nuk kanë gëzuar asnjë për-


fitim nga programet shtetërore të nxitjes së punësimit gjatë 2016, ndërsa 47% e tyre nuk kanë fare njohuri me politikat shtetërore të punësimit.

32) http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/92-2016.pdf

Grafiku 11. Arsye për mos përfitimin nga Politikat Shtetërore të Punësimit



Standarti 2: Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin



Legjislacioni:

Pas disa vitesh diskutimi mbi ligjin për vullnetarizmin, në Prill 2016 Parlamenti Shqiptar aprovoi Ligjin nr 45/2016 "Mbi Vullnetarizmin"³², bazuar në projektligjin e prezantuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Ky ligj përcakton parimet kryesore, kushtet dhe kriteret për kryerjen e punës vullnetare në Shqipëri me qëllim rregullimin e punës vullnetare dhe rritjen e aktiviteteve jofitimprurëse të qytetarëve për mirëqenien e një individi tjetër apo publikut të gjerë. Bazuar në ligj, ata që ofrojnë punën vullnetare³³ duhet të pajisen me një regjistër për kontratat e vullnetarëve dhe duhet të lajmërojnë Shërbimin Kombëtar të Punësimit brenda 10 ditëve të deklarimit të kontratës së vullnetarit. Veç kësaj, neni 22 i këtij Ligji përcakton që ofruesit e punës vullnetare duhet të mbulojnë sigurimin

33) Ofruesit e vullnetarizmit mund të jenë entitete publike, komunitetet fetare, ose organizatë jofitimprurëse. (ligji nr 45/2016 mbi Vullnetarizmin).

34) Ligji nr 45/2016 mbi vullnetarizmin, neni 11

35) Ligji nr 45/2016 mbi vullnetarizmin, Neni 21, 26, dhe 27

shëndetësor në rastet e aksidenteve gjatë periudhës së kontratës.


Ligji përshkruan çfarë duhet të ketë përmbajtja e kontratës ndërmjet ofruesve dhe vullnetarëve, siguron kohëzgjatjen e punës vullnetare e cila nuk duhet të kalojë 5 orë në ditë dhe 25 orë në javë³⁴ dhe garanton që vullnetarët të jenë të informuar rreth kushteve, të drejtave, detyrimeve dhe përfitimeve para fillimit të punës vullnetare në mënyrë që të jenë të vetëdijshëm për të gjitha rrethanat dhe veçoritë e angazhimit.

Ligji mbi Vullnetarizmin është aprovuar në Prill 2016, dhe deri më tani aktet nën-ligjore të përcaktuara në ligj për të rregulluar marrëdhënien midis vullnetarit dhe ofruesit të punës vullnetare, si regjistri i kontratave për vullnetarët, librezat e vullnetarit, dhe kodi i etikës për vullnetarizmin³⁵, nuk janë aprovuar ende. Ndërkohë në ligj nuk ka nene që përcaktojnë se si çështjet fiskale për aktivitetet vullnetare do të rregullohen në ligjet respektive lidhur me këtë çështje. Nuk ka informacion të publikuar në lidhje me incentivat dhe programe të mbështetura nga shteti për zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizmit.

Praktika:

Sikurse edhe në raportin e MM 2015, pjesa dërmuese e OSHC-ve të intervistuar (41%), kanë 1-10 vullnetarë aktiv gjatë 2016, sikurse është paraqitur në Grafikon 12, ndërsa 16% e organizatave nuk kanë vullnetarë aktivë gjatë 2016.

Grafiku 12. Vullnetarët Aktiv gjatë 2016 në OSHC-të e intervistuar



Ligji mbi Vullnetarizmin ende nuk po zbatohet për shkak të mungesës të akteve nën-ligjore që do të mundësonin zbatimin e tij. Si rezultat, OSHC-të akoma nuk janë ndeshur me procedurat dhe detyrimet administrative për organizimin e vullnetarëve dhe aktiviteteve vullnetare.

Rreth 65% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan se janë në dijeni të aprovimit të ligjit mbi vullnetarizmin në Prill 2016. 48% e OSHC-

ve të intervistuar konsiderojnë se kuadri ligjor stimulon disi angazhimin vullnetar, 50% konsiderojnë se procedurat administrative mbi punën vullnetare janë disi të lehta, dhe 40% e tyre konsiderojnë që obligimet e përshkruara në ligj janë disi të arsyeshme, ndërsa 41% e OSHC-ve të intervistuar nuk kanë informacion nëse procedurat për vullnetarët e huaj është e njëjtë më atë për vullnetarët vendas.

Vlerësimi i Standardit 2, të Nën-fushës 2.3., reflekton gjithashtu vlerësimet e indikatorëve që vijojnë në Udhëzuesin e BE për mbështetjen e Shoqërisë Civile 2014-2020. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin indikator janë:

1.2.a. Numri i punonjësve në OSHC (përhershëm dhe me kohë të pjesshme)

Nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin total të punonjësve brenda sektorit të OSHC-ve. Bazuar në përgjigjet e OSHC-ve të intervistuar, 15% e tyre nuk kanë punonjës me kohë të plotë, ndërsa 25% e tyre nuk kanë punonjës me kohë të pjesshme. Më shumë se gjysma e OSHC-ve kanë 1-5 punonjës me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, respektivisht 53% dhe 58%. ARSIS është e vetmja organizatë e intervistuar që ka më shumë se 30 punonjës me kohë të plotë.

1.2.d. Numri i vullnetarëve në OSHC-të për lloji i OSHC/sektori

Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e vullnetarëve në OSHC. Shumica e OSHC-ve (41%), kanë 1-10 vullnetarë aktivë, ndërsa 16% e organizatave nuk kanë patur asnjë vullnetarë aktiv gjatë 2016.

1.2.f. Cilësia e kuadrit ligjor

Kuadri ligjor mbi punësimin nuk ofron trajtim ndryshe për OSHC-të dhe nuk lehtëson punësimin tek OSHC-të në krahasim me sektorët e tjerë. Kuadri ligjor nuk merr në konsideratë natyrën dhe qëllimin e punës së OSHC-ve, duke i imponuar për të regjistruar dhe paguar kontributet sociale dhe shëndetësore për të paktën një punonjës, duke përfshirë edhe organizatat me baza vullnetare.


Ligji mbi Vullnetarizmin u miratua nga parlamenti Shqiptar në Prill 2016, por nuk ka akte ligjore që rregullojnë trajtimin tatimor për OSHC-të dhe vullnetarët.

36) <http://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-civil-society-development-country-report-for-albania-2/>

Fusha 3: Marrëdhënia Shtet - OSHC

Nën-Fusha 3.1 Kuadri Ligjor dhe praktik për bashkëpunim

Standarti 1: Shteti nje, përmes strategjive dhe politikave, rëndësinë e zhvillimit të një bashkëpunimi me sektorin




Legjislacioni:

Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile është i vetmi dokument strategjik që nje rëndësinë e zhvillimit dhe bashkëpunimit me sektorin. Dokumenti është aprovuar në vitin 2015, dhe përshkruhet në Raportin e MM të vitit 2015³⁶.

Praktika:

Vetëm 47% e OSHC-ve të anketuara shprehen se kanë informacion për ekzistencën e dokumentit strategjik për bashkëpunimin e qeverisë me OSHC-të si Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile dhe Ligji për Themelimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Pak më shumë se gjysma e organizatave (55%) të cilat kanë informacion mbi dokumentet strategjik raportuan që nuk janë përfshirë në përgatitjen e këtyre dokumenteve, ndërsa (25%) e organizatave janë përfshirë pjesërisht dhe (20%) u shprehen që janë përfshirë në përgatitjen e këtyre dokumenteve.

Standarti 2: Shteti nje, përmes veprimtarisë së institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të



Legjislacioni:

Duke vijuar me zhvillimet për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile në vitin 2015, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) u krijua në Janar të vitit 2016. Sikurse është theksuar në ligj, Këshilli ka 27 anëtar, 13 nga të cilët janë nga OSHC-të, 13 nga institucionet shtetërore, dhe 1 nga Këshilli Kombëtar i Biznesit.

Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga OSHC-të nisi në Dhjetor të vitit 2015, kur Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në rolin e sekretariatit të KKSHC, realizoi disa konsultime me OSHC-të për emërimin e kandidatave. Procesi i votimit për përfaqësuesit e OSHC-ve u organizua elektronikisht në periudhën Prill – Maj 2016 dhe bazuar në të dhënat e faqes së internetit të AMSHC-së³⁷ 1141 OSHC votuan në mënyrë elektronike. Sipas AMSHC-së procesi i votimit në mënyrë elektronike shfaq problematika në rezultimin e shumë votave të pa vlefshme.

Bazuar në listën e anëtarëve të Këshillit të publikuar në faqen e internetit të AMSHC, Ministria e Shëndetësisë nuk përfaqësohet sic kërkohet me ligj, ndërsa Këshilli Kombëtar Ekonomik që duhet të kishte një anëtar, ka dy anëtarë.

Sipas të dhënave të publikuara në faqen e internetit të AMSHC është organizuar vetëm një takim më 23 Qershor 2016 nga Këshilli, edhe pse kërkesa ligjore është që të organizohen tre takime në vit.

Takimi shërbeu për të prezantuar anëtarët dhe për të dhënë mandatin një grupi të brendshëm

të punës me përgatitjen e Rregullores së Brendshme të Këshillit. Këto rregulla vendosin se kur dhe si thirren takimet e Këshillit, kur njoftohen dhe organizohen takimet e parashikuara në nenin 5 të ligjit. Nuk ka informacion tjetër në dispozicion kur do të organizohet takimi i ardhshëm.

Një nga rezultatet e pritshme të Këshillit, është përgatitja dhe monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të mjedisit mundësues të shoqërisë civile.

Në nivel ministrie, bazuar në informacionin e mbledhur nga 13 Ministri (Ministria e Kulturës; Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Ministria Arsimit dhe Sportit; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Ministria e Financave; Minister për Inovacionin dhe Administratën Publike; Ministria e Energjisë dhe Industrisë; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë; Ministria e Integritimit Evropian) të cilat ju përgjigjen kërkesës për informacion nga PA në procesin e konsultimit, personi i kontaktit për bashkëpunim dhe mbështetje të OSHC-ve është Koordinatori për të Drejtën e Informimit ose Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Kuvendi i Shqipërisë ka emëruar një koordinator për grupet e interesit dhe shoqërinë civile, i cili

është përgjegjës për të koordinuar dhe lehtësuar partneritetet ndërmjet Parlamentit Shqiptar dhe grupeve të interesit, shoqërisë civile dhe partnereve social.

Praktika:

Vetëm 47% e OSHC-ve të anketuara shprehen se kanë informacion për institucionet shtetërore për bashkëpunimin e qeverisë me OSHC-të, si Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile; Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile; Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (RYCO); Departamenti i Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj pranë Zyrës së Kryeministrit; Këshilli Kombëtar për Integritimin Evropian.

Shumica e OSHC-ve (91%) u shprehen se gjatë vitit 2016 kanë komunikuar me organet shtetërore për bashkëpunim me shoqërinë civile. Nga 96 OSHC, 25 prej tyre u shprehën që komunikojnë rregullisht me këto organe, 53 OSHC u shprehën se komunikojnë herë pas here, dhe 4 OSHC deklaruan që nuk kanë komunikuar fare.

Ndërsa Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile nuk ka funksionuar gjatë vitit 2016, praktika tregon që mekanizmat e tjerë të bashkëpunimit me OSHC-të nuk kanë burime të mjaftueshme dhe mandat për lehtësimin e një dialogu ndërmjet OSHC-ve dhe Qeverisë. Nuk ka raste të politikave të inciuara dhe zhvilluara nga këto mekanizma në bashkëpunim me OSHC-të.

Vlerësimi i Standardit 3, i Nën Fushës 3.1 reflekton gjithashtu vlerësimet e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vëndet e Zgjerimit 2014- 2020. Gjetjet janë bazuar në targetin për secilin indikator.

3.1.b. Cilësia e strukturave dhe mekanizmave ekzistuese për dialog dhe bashkëpunim midis OSHC-ve dhe institucioneve publike lidhur me: - - përfaqësimin e OSHC-së në përgjithësi, - përfaqësimin e OSHC-ve më të vogla/më të dobëta, - prezencën dhe disponueshmërinë, - perceptimin e qeverisë mbi cilësinë e strukturave dhe mekanizmave, - perceptimin e OSHC-ve për strukturat dhe mekanizmat.


- Në Qershor të vitit 2016 u themelua Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, një mekanizëm konsultues kolegjal që ka për qëllim garantimin e bashkëpunimit midis shtetit dhe organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Këshilli ka një përfaqësim të barabartë të shoqërisë civile dhe shtetit, si dhe përfaqësohet nga sektorë të ndryshëm që mbulojnë OSHC-të.

- Sic është përcaktuar me ligj, pritet që Këshilli të ketë një impakt pozitiv në mjedisin mundësues të shoqërisë civile bazuar në përpjekje të përbashkët të përfaqësuesve të shtetit dhe shoqërisë civile në Këshill; Këshilli ka ende punë për të bërë si një entitet i përbashkët në përgjigje të pritshmërive të të dyja palëve.

37) <https://www.facebook.com/media/set/?set=a.960960550696848.1073741914.506935452766029&type=3>

Nën-fusha 3.2 Përfshirja në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes

Standarti 1: Ekzistojnë standarde që mundësojnë përfshirjen e OSHC-ve në vendimarrje, të cilat lejojnë kontributin e OSHC-ve në kohën e duhur.



Legjislacioni:

Kuadri ligjor që ndikon përfshirjen e OSHC-ve në vendim-marrje nuk ka ndryshuar gjatë vitit 2016. Ligji nr 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" ka çuar përpara kërkesën nga autoritetet publike për konsultime draft ligjesh dhe politikave me publikun. Çdo autoritet publik emëron një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik. Vendim i Këshillit të Ministrave nr 828, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave për Krijimin dhe Administrimin e Regjistrimit elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik", miratoi krijimin, funksionimin, administrimin dhe monitorimin e regjistrimit elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik dhe botimin e tij në formatin e një portali elektronik <http://konsultimipublik.gov.al/RENJK>.

Bazuar në të njëjtin vendim, regjistri elektronik administrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe duhet të përfshijë: (i) të dhëna primare - të gjithë informacionin dhe aktet nënligjore që janë publikuar për herë të parë në regjistrin elektronik, dhe (ii) të dhëna dytësore - të gjitha aktet nënligjore të marra në bazën e të dhënave të institucioneve publike, të botuara për herë të parë sipas legjislacionit përkatës/ sektorit të institucionit publik.

38) <http://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2016/07/konsultimi-publik-sfidat-e-vitet-te-pare-te-zbatimit-te-ligjit.pdf>

39) ibid, page 29

Konsultimi është i detyrueshëm vetëm për projekt ligjet, dokumentet strategjik kombëtar dhe vendor, dhe për politikën me interes të lartë publik, por nuk është i detyrueshëm për aktet normative të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Aktet normative nuk janë subjekt i Ligjit Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Ligji Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik nuk parashikon asnjë sanksion administrativ kundrejt institucioneve publike ose personin përgjegjës për njoftimin dhe konsultimin publik; nuk parashikon ankimimin e vendimit të autoritetit publik.

Organizimi i konsultimeve publike me OSHC-të kërkon njohuri specifike dhe aftësi nga nënpunësit publik të përfshirë në proces. Siç është verënjtur në faqen e internetit të Shkollës Shqiptarë të Administratës Publike (ASPA) në kalendarin e publikuar të trajnimeve nuk ka trajnime për nënpunësit publik për përfshirjen e OSHC-ve në punën e institucioneve publike.

Praktika:

Pas miratimit të Ligjit nr 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 828, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave për Krijimin dhe Administrimin e Regjistrimit elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik" u ndërtua një faqe interneti për konsultimet publike. Faqja e internetit është aktive por nuk disponon informacion.


Sipas raportit të përgatitur nga ResPublica për efektivitetin e ligjit Për Njoftimin dhe Konsultimin publik³⁸, rezultoi se ka një numër shumë të vogël të projekt-akteve të publikuara në faqen e internetit <http://www.konsultimipublik.gov.al/>, të gjitha elementët që duhet të përmbajnë dosjet e projekt akteve mungojnë, gjithashtu nuk ka komente ose rekomandime për projekt aktet e publikuara. Në të njëjtin raport³⁹, gjithashtu theksohet se 18% e institucioneve të monitoruara, janë subjekt i ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, si dhe disponojnë regjistrin për publikimin e projekt akteve në përputhje me ligjin.

Nga informacioni i publikuar në faqet e internetit të ministrave, rezultoi se të gjitha Ministratë

kanë emëruar një koordinator për të drejtën e informimit në përputhje me ligjin Nr. 119/ 2014 Për të Drejtën e Informimit. Gjithashtu, ministratë e mëposhtme si: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme kanë publikuar në faqet e tyre të internetit informacion me kontaktet e koordinorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Grafiku 13, tregon nivelin e kënaqshmërisë së

Grafiku 13. Karakterizimi i procesit të politikë bërjes dhe vendim marrjes bazuar në përvajën e OSHC-ve të intervistuar



Bazuar në Ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", Partnerët Shqipëri i dërgoi kërkesa për informacion ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë për numrin e konsultimeve publike gjatë muajit Dhjetor 2015 - Shtator 2016; stafin e emëruar për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e përfshirjes së OSHC-ve në konsultimet publike; përfshirjen e përfaqësuesve të OSHC-ve në institucionet ndërsektoriale dhe këshillimore.

Në përgjigje të kërkesës së Partnerëve Shqipëri drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, rezultoi se Komisionet e Përhershme kanë kryer 16 konsultime publike, 19 dëgjesa publike gjatë vitit 2016. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut janë komisionet e vetme të përhershme që kanë organizuar konsultime publike, 6 nga 10 konsultime publike me pjesëmarrjen e 60 përfaqësuesve të grupeve të interesit.


OSHC-ve me cilësinë e procesit të konsultimit. Është vënë re që 44% e OSHC-ve të intervistuar kanë marrë informacionin e kërkuar dhe kohë të mjaftueshme për të marrë pjesë në proces, dhe konsultimi ka ndodhur në fazat e hershme. Megjithatë, dy çështje kryesore janë ngritur nga OSHC-të e intervistuar për sa i përket cilësisë së konsultimit. Së pari, mos konsiderimi i rekomandimeve të dhëna dhe së dyti, mungesa e shpjegimeve të arsyes se pse nuk janë marrë parasysh. Kjo e fundit bie në kundërshtim me Ligjin Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Ndërsa, Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetit ka organizuar 7 dëgjesa publike me pjesëmarrjen e 39 përfaqësuesve nga grupet e interesit; Komisioni i Ekonomisë dhe Financës ka organizuar 3 dëgjesa publike me pjesëmarrjen e 9 përfaqësuesve të grupeve të interesit, dhe Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese Tregtisë dhe Mjedisit ka organizuar 9 dëgjesa publike me pjesëmarrjen e 37 përfaqësuesve nga grupet e interesit.

Ministratë e linjës (13 ministri) që janë përgjigjur kërkesës së Partnerëve Shqipëri deklaruan që kanë organizuar konsultime publike me grupet e interesit dhe kanë publikuar të gjitha draft ligjet dhe draft politikën në faqet e tyre të internetit. Megjithatë, vetëm Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), dhe Ministria e Integritimit Evropian mundësoi informacionin mbi numrin e agjencive dhe organizatave që janë informuar dhe kanë marrë pjesë në takimet konsultuese, ndërsa ministratë e

tjera nuk mundësuan shifra të sakta për numrin e OSHC-ve të informuara dhe pjesëmarrëse në konsultimet publike. Në bazë të dhënave të mundësuar nga Ministria e Integritimit rreth 900 organizata janë informuar nga gazeta për draft ligjet e reja dhe strategjitë e diskutuara në vitin 2016, ndërsa në konsultimet e realizuara nga (MZHETTS), kanë marrë pjesë 18 përfaqësues nga grupet e interesit, pjesa më e madhe përfaqësues nga dhoma e tregtisë dhe agjensitë e turizmit.

Standarti 2: Të gjitha projekt-ligjet dhe politikat janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku në kohën e duhur



Legjislacioni:


Kuadri ligjor ekzistues, specifikisht Ligji “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” detyron institucionet publike që të publikojnë të gjitha draft ligjet, ligjet dhe dokumentet politike. Kërkesat ligjore garantojnë kohë të mjaftueshme që OSHC-të të japin sugjerimet e tyre mbi projekt ligjet dhe politikat.

Gjithashtu, ligji parashikon që të bëhet publike një përmbledhje e sugjerimeve të dhëna për projekt ligjet dhe politikat e cila është pjesë e paketës së draft ligjeve për miratim. Nga ana tjetër, nëse rekomandimet nuk pranohen, duhet të bëhet një përmbledhje e argumentimit të arsyes që nuk janë marrë në konsideratë. Ligji parashikon mundësi për ta adresuar/korrigjuar nëse dispozitat për konsultime nuk respektohen nga grupet e interesit.

Praktika:

Krahasuar me Raportin e Monitorimit të 2015, sipas të dhënave me OSHC-të e intervistuar ka një përmirësim për sa i përket aksesit në draft ligje dhe politika sic tregohet në Grafikon nr.14. Megjithatë, më shumë se gjysma e OSHC-ve të intervistuar (59%) nuk bien komplet dakord që draft ligjet, politikat dhe ligjet janë mundësuar për publikun, dhe (54%) e OSHC-ve mendojnë se draft ligjet, politikat dhe ligjet janë botuar në kohën e duhur.


Grafiku 13. Aksesueshmëria e draft ligjeve dhe politikave



Bazuar në intervistat e OSHC-ve , 36% e tyre raportojnë që kanë ushtruar të drejtën për informacion, dhe 44% e tyre kanë marrë informacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar,


26% e tyre kanë marrë informacion por me vonesë, 15% tyre kanë marrë informacion të pjesshëm dhe 12% e tyre nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

Grafiku 14. Përgjigjja publike për të drejtën e Informimit bazuar në eksperiencën e OSHC-ve të intervistuar



Karaste në të cilat OSHC-të e ushtrojnë të drejtën për tu ankuar për refuzimin e informacionit si, Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Organizata ka dërguar një kërkesë për informacion Ministrisë së Shëndetsisë por nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga ministria. Në vijim, organizata e ankimoi rastin pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili është një institucion publik përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e pajtueshmërisë lidhur me ligjin për të drejtën e informimit. Komisioneri pasi shqyrtoi kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit vendosi kundra Komitetit të Helsinkit, sepse sipas tij nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara me ligj. Vendimi u apelua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës e cila vendosi në favor të organizatës.

Standarti 3: Përfaqësuesit e OSHC-ve janë partnerë të barabartë në diskutime në organet ndërsektoriale dhe zgjidhen përmes kriterëve dhe një procesi të mirëpërcaktuar



Legjislacioni:


Nuk ka asnjë ligj specifik që rregullon pjesëmarrjen e OSHC-ve në organet ndërsektoriale konsultative. Megjithatë në bazë të informacionit të dhënë nga ministrinë ekzistojnë organë ndërsektoriale konsultative të krijuara me pjesëmarrjen e OSHC-ve si të tilla si Këshilli Kombëtar për Integritimin Evropian, Këshilli Kombëtar i Punës, Komiteti Konsultativ i Sektorit Privat të Turizmit, Këshilli Koordinues për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Këshilli tatimor, Komisioni për të Drejtat e Konsumatorëve dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore i ngritur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me pjesëmarrjen e OSHC-ve.

Praktika:

Sipas sondazhit, 31% e OSHC-ve kanë marrë pjesë në një organ këshillues/ konsultativ në vitin 2016, si Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, Komisioni Këshillues Ad Hoc për Reformën në Arsim, Komitetet Rajonale të Anti-Trafikimit, Komiteti Ad Hoc për Mekanizmat Kombëtar të Referencës së viktimave të trafikimit, Këshilli Ndër-ministror për Aftësinë e Kufizuar, Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, etj.

Bazuar në përvojën e OSHC-ve, organet konsultative nuk janë shumë aktive (59% disi aktive dhe 4% jo aktive). Transparenca e procesit të përzgjedhjes së OSHC-ve si pjesë e këtyre organeve konsultative mbetet shqetësim. Ky proces është vlerësuar në një farë mënyre transparente nga 46% dhe aspak transparente nga 15% e OSHC-ve. Ka një përmirësim të dukshëm për sa i përket nivelit të lirisë në të shprehurit e kritikave si pjesë e procesit konsultativ me 54% të OSHC-ve që bien dakord.

Grafiku 16. Pjesëmarrja në organet konsultative bazuar në eksperiencën e OSHC-ve të intervistuar



Vlerësimi i Stadarit 3, Nën fusha 3.2., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e Shoqërisë Civile 2014-2020.


3.1.a. Përqindja e ligjeve/ akteve nënligjore, strategjive dhe reformave politike të konsultuara me OSHC-të -lidhur me: - aksesin e duhur ndaj informacionit; - kohën e mjaftueshme për të komentuar; - përzgjedhja dhe përfaqëshueshmëria/ diversiteti i grupeve të punës; - njohja e kontributit; - shkallën në të cilën informacioni merret në konsideratë;- reagimin/ publikimin e rezultateve të konsultimit.

-Nuk ka informacion publik në lidhje me përqindjen e ligjeve/ akteve nënligjore, strategjive dhe reformave politike të cilat janë konsultuar në mënyrë efektive me OSHC-të.

Sipas të dhënave nga intervistimi i OSHC-ve, 67% e tyre shprehën se nuk janë bërë publike nga institucionet arsyet e mos konsiderimit të rekomandimeve të tyre. Përzgjedhja e OSHC-ve në organet konsultative perceptohet disi transparente nga 46% e OSHC-ve, dhe aspak transparente nga 15 % e OSHC-ve të vëzhguara.

Nën-fusha 3.3 Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

Standarti 1: OSHC-të janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe konkurojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë



Në aspektin ligjor, gjatë 2016 nuk ka ndryshime në Ligjin Mbi Prokurimin Publik, i cili mbetet a vetmja bazë ligjore që OSHC-të të marrin pjesë në tenderat publik në çdo sektor. Rregullat e tenderimit janë të njëjta si për OSHC-të dhe për kompanitë private, kriteri kryesor i vlerësimit të ofertave është çmimi, duke i vënë OSHC-të në një situatë jo të favorizueshme.


Gjithashtu, Ligji Mbi Ndërmarrjet Sociale Nr. 65/2016 u miratua në Qershor të vitit 2016. Ligji rregullon organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale, duke përcaktuar kriteret për statusin e ndërmarrjeve sociale. Sipas ligjit, ndërmarrja sociale nuk është një organizatë jo fitimprurëse, e cila e merr statusin nga vendimi i ministrit përgjegjës për çështjet sociale. Ligji mundëson forma mbështetjesh për ndërmarrjet sociale si, si subvencionet shtetërore për ndërmarrjet ose të punësuarit në këto subjekte, taksat dhe donacionet. Ligji inkurajon qeverinë lokale për të nxitur pjesëmarrjen e ndërmarrjeve sociale në tenderat publikë.

Praktika:

Praktika tregon që pjesëmarrja e OSHC-ve në tenderat publik mbetet shumë e ulët, vetëm 9 nga OSHC-të e intervistuar kanë dhënë oferta, nga ku janë përzgjedhur vetëm 4 (2 në ofrimin e shërbimeve sociale, 1 në mbrotjen e mjedisit dhe

1 për prodhime e punimeve artizanale artistike.) Arsyet e mos marrjes pjesë në tenderat publikë siç raportohet nga 91% e OSHC-ve kanë të bëjnë me mungesën e informacionit në lidhje me tenderat publik, mungesës së besimit në një proces transparent, mungesës së mundësive dhe kuadri mbështetës për konkurueshmërinë e OSHC-ve.

Standarti 2: Shteti është angazhuar për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i ofruar për një periudhë afatgjatë



Legjislacioni:


Financimi i shërbimeve nëpërmjet kontratave shtetërore mbetet i ulët, rregullat dhe procedurat ligjore të tenderimit i imponojnë pengesa organizatave. Gjithashtu, fondet shtetërore të alokuara për shërbime janë për afat të shkurtër dhe OSHC-të nuk mund të angazhohen në kontrata afatgjata.

Kjo situatë, është e njëjtë edhe për sa i përket angazhimit të qeverisë në financimin e shërbimeve të ndryshme, ashtu si në vitet e mëparshme. (Raporti i MM 2015, 2014 & 2013).

Praktika:

Situata paraqitet e njëjtë dhe në nivle praktik. Ka ende një numër të limituar OSHC-sh, të cilat përfitojnë financim publik përmes procedurave të prokurimit publik (vetëm 4 nga 96 OSHC të vëzhguara). Fondet nuk mbulojnë shpenzimet bazë të shërbimeve për të cilat OSHC-të janë kontraktuar, ka vonesa në pagesa dhe janë kontrata afat-shkurtra.

Standarti 3: Shteti ka përcaktuar procedura të qarta për kontraktimin e shërbimeve të cilat lejojnë përzgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë edhe OSHC-të.



Legjislacioni:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Mbi Prokurimin Publik" i ndryshuar, nuk diskriminon asnjë subjekt publik privat për të marrë pjesë në një tender të hapur publik duke përfshirë OSHC-të. Çmimet jepen në bazë të dy kriterëve kryesore, si çmimi më i ulët dhe oferta më e favorshme ekonomike.


E drejta e ankimit është e garantuar. Ligji parashikon 7 ditë periudhë pritje të ankesave nga ofertuesit për tu apeluar te autoritetet kontraktuese dhe autoriteti kontraktues nuk mund të vazhdojë procedurat e prokurimit, derisa ankesa është zgjidhur.

Praktika:

Vëzhgimi tregon që 3 nga 4 OSHC-të që manaxhojnë kontrata publike nëpërmjet tenderave publik kanë qënë të përfshirë në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve, ndërsa vetëm një organizatë është përfshirë vetëm në vlerësimin e nevojave.

OSHC-të kanë identifikuar sfida të ndryshme duke filluar nga kërkesa administrative të tepërta për Procedurat e licensimi/regjistrimi, që janë të komplikuar, vonesa në disbursimin e fondeve, mugesë fondesh për të mbuluar kostot administrative. Këto kontrata parashikojnë fonde vetëm për pagat e punonjësve.

Standarti 4: Ekziston një sistem i qartë i llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve



Legjislacioni:

Sipas kuadrit ligjor, autoritetet publike respektive kanë të drejtën të ushtrojnë kontroll dhe monitorimin e cilësisë së shërbimeve dhe të mbikëqyrin menaxhimin financiar të kontratës nga ana e kontraktorit.

Praktika:

OSHC-të që kanë përfituar kontrata konfirmojnë që nuk janë objekt i kontrollit të tepruar nga autoriteti kontraktues, dhe monitorimi është kryer në përputhje me ligjin duke njoftuar paraprakisht.

IV. Burime të Përdorura dhe Linqe që u hulumtuan



Lista e dokumentave ligjorë dhe strategjikë, raporte dhe analizat e përdorura

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Online) http://www.pp.gov.al/ëeb/kushtetuta_2016_1082.pdf
2. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014 "Për Dispozitat Zbatuese Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë"
3. Direktiva nr. 22, datë 19.11.2014 "Për Supervizimin nga Autoritetet Tatimore në Mbështetje të Parandalimit e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit".
4. Udhëzimi nr.62, datë 17.09.2015 " Për shpalljen e Standartit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve dhe zbatimin e detyrueshëm të tij", nxjerrë nga Ministria e Financave.
5. Udhëzim Nr. 6 Date 30.01.2015 "PËR TVSH-NË"
6. Ligji nr. 7795, datë, 20.9.1995, Për Nxitjen e Punësimit, i ndryshuar
7. Ligji nr. 7892, datë, 21.12.1994 Mbi Sponsorizimin, i ndryshuar
8. Ligji nr. 8778, datë, 23.04.2001 " Për Tubimet"
9. Ligji nr. 8789 datë 07.05.2001 " Për Organizatat Jofitimprurëse
10. Ligji nr. 8789 datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", Fletorja Zyrtare 28/2001
11. Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
12. Ligji Nr 92/2014 Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar në Republikën e Shqipërisë
13. Ligji nr. 112/2015, datë 15.10.2015 "Për Inspektimin Financiar Publik", Fletorja Zyrtare 186/2015
14. Ligji nr. 45/2016, datë 28.04.2016 "Mbi Vullnetarizmin", Fletorja Zyrtare 92/2016
15. Ligji nr. 65/2016, datë 9.06.2016 "Për Ndërmarrjet Sociale", Fletorja Zyrtare 92/2016
16. Respublika (2015)Konsultimi Publik, Sfidat e Vitit te Parë të Zbatimit të Ligjit" faqe 29
17. USAID (2015), Raporti I Indeksit të Qëndrueshmërisë për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazia, faqe 15, (Online) https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1861/Europe_Eurasia_CSOSIRReport_2015_Update8-29-16.pdf

Useful Links

- URL: <http://www.amshc.gov.al>
 URL: <http://freedomhouse.org/country/albania>
 URL: <http://www.kultura.gov.al>
 URL: <http://www.lotaria.al>

V. Shtojca 1



MATRICA E MONITORIMIT MBI MJEDISIN MUNDËSUES PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

PYETËSOR I STANDARTIZUAR PËR MATRICËN MONITORUESE 2016



BALKAN CIVIL SOCIETY DEVELOPMENT NETWORK

PYETËSOR I STANDARTIZUAR PËR STUDIMIN MBI MATRICËN MONITORUESE PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

SHTATOR, 2016



Qasja e standartizuar metodologjike

Ky pyetësor ka për qëllim të kontribuojë në monitorimin gjithëpërfshirës të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor⁴¹ dhe Turqi, si dhe ofrimi i rekomandimeve cilësore për përmirësimin e politikave qeverisëse. Ky pyetësor është zhvilluar për të unifikuar në nivel maksimal të dhënat cilësore dhe sasiore të mbledhura nga OSHCtë gjatë realizimit të monitorimit. Qëllimi i pyetësorit të standartizuar është të evidentojë trendet e përgjithshme rreth tre fushave të monitoruara bazuar në udhëzuesin e Matricës Monitoruese për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, duke e aplikuar në mënyrë uniforme, përmes një pyetësori online. Ndërsa asnjë pyetësor që targeton OSHCtë nuk mund të jetë plotësisht përfshirës duke marrë parasysh mungesën e të dhënave zyrtare dhe përfundimtare mbi të dhënat demografike të OSHCve, ky pyetësor duhet të bëjë përpjekje në vlerësimet e përafërta përsa i përket përfaqësimit të OSHCve në lidhje me:

- Fushën e veprimtarisë së organizatës,
- Numrin e punonjësve;
- Qarkullimin vjetor;
- Vendndodhjen gjeografike;
- Datën e regjistrimit.

Autorët nuk kanë qëllim të mbështeten vetëm në pyetësorin për mbledhjen e të dhënave. Autorët i inkurajojnë ekspertët e çdo vendi të plotësojnë të dhënat e marra nëpërmjet pyetësorit duke përdorur metoda të tjera të mbledhjes së të dhënave siç përshkruhet në dokumentin Metodologjia e Propozuar për Vlerësimet e Vendeve dhe marrjen e informacioneve shtesë nga përfaqësues të OSHCve. Të gjitha përgjigjet e pyetësorit duhet të lidhen vetëm me periudhën nga 1 Dhjetori, 2015 deri në 30 Shtator, 2016 si periudha përkatëse monitoruese.

Pyetësori kërkon 30 minuta kohë për tu plotësuar, megjithatë, duke konsideruar rolin tuaj të rëndësishëm në sektorin e shoqërisë civile në vend, kontributi juaj do të ishte i një rëndësie të madhe në kryerjen e monitorimit për vitin 2016. Ne ju nxitim të plotësoni pyetësorin jo më vonë se 15 tetor 2016. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni kkeruti@partnersalbania.org

Pyetësori është përgatitur në kuadër të projektit “Balkan Civil Society Acquis: Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHCve”. Projekti po zbatohet nga Balkan Civil Society Development Network (BCSDN) dhe anëtarët e tij.

41) Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Macedonia, Montenegro and Serbia

Informacion i përgjithshëm

1. Emri i plotë i Organizatës _____
2. Emri i të Intervistuarit _____
3. Pozicioni i të intervistuarit në organizatë _____
4. Adresa e Organizatës _____
5. Telefon _____
6. Email _____
7. Viti i themelimit _____
8. Viti i regjistrimit _____
9. Lloji i Organizatës
 - Shoqatë
 - Fondacion
 - Qendër
 - Ndërmarrje Sociale
 - Tjetër (Specifiko) _____
10. Fusha e Veprimtarisë së OSHCsë (Ju lutem rrethoni të gjitha alternativat e aplikueshme)
 - Biznes
 - Gruaja dhe Çështjet Gjinore
 - Mjedisi
 - Të Rinjtë dhe Fëmijët
 - Qeverisja e mirë (Demokracia, Ligji i së drejtës, Transparenca, Antikorrupsioni)
 - Të drejtat e njeriut
 - Marrdhëniet Ndërkombëtare dhe Integrimi Europian
 - Kultura
 - Edukimi dhe Kërkimi shkencor
 - Shërbimet Sociale
 - Shëndeti dhe Kujdesi Shëndetësor
 - Informacioni, Komunikimi dhe Media
 - Shërbime ndaj personave me nevoja të veçanta
 - Tjetër (Specifiko) _____

10.1. Në cilën prej fushave të mësipërme keni ushtruar më shumë veprimtarinë tuaj gjatë vitit 2016? (zgjdh vetem një fushë nga të mësipërmet)

11. Numri i Punonjësve/personave të përfshirë në organizatë gjatë 2016?

- Me kohë të plotë _____
- Me kohë të pjesshme _____
- Të kontraktuar _____

12. Numri i vullnetarëve aktivë gjatë vitit 2016 _____

13. Të ardhurat vjetore për vitin financiar (2015):

- Më pak se 5,000 EUR
- Nga 5,001 deri në 10,000 EUR
- Nga 10,001 deri në 50,000 EUR
- Nga 50,001 deri në 100,000 EUR
- Nga 100,001 deri në 500,000 EUR
- Nga 500,001 deri në 1,000,000 EUR
- Mbi 1,000,000 EUR

Fusha 1. Garancitë themelore juridike të lirive Liria e organizimit

(Për OJFtë e regjistruara para dt. 1 dhjetor 2015 të vazhdohet direkt me pyetjen nr.2)

1. (Vetëm për OSHCtë e regjistruara nga 1 Dhjetori 2015 deri në 30 Shtator 2016): Si e vlerësoni procesin e regjistrimit?

	Dakort	Disi Dakort	Aspak Dakort
Procedura e regjistrimit është e thjeshtë.			
Kostot e regjistrimit nuk janë të larta.			
Kohëzgjatja e procedurës së regjistrimit është brenda afateve kohore të parashikuara në ligj.			
Dokumentacioni i kërkuar nuk përbën barrë për organizatën.			
Tjetër (Ju lutem shpjegoni):			

1.1. Ju lutem shpjegoni dhe jepni shembuj në rast se keni hasur sfida gjatë procedurës së regjistrimit?
.....

1.2. Sa ditë ju ka zgjatur procesi i regjistrimit të organizatës? (Nëse nuk e dini me saktësi, jepni një numër të përafërt)

1.3. Sa ka qenë kosto e regjistrimit të organizatës?

2. A është organizata juaj pjesë e ndonjë koalicioni/rrjeti kombëtar/ndërkombëtar? (Nëse jo, kalo direkt te pyetja nr. 3)

Po Jo

2.1. Nëse po, nga përvoja e organizatës suaj, regjistrimi dhe pjesëmarrja në një koalicion/rrjet kombëtar/ndërkombëtar është:

- E thjeshtë, nuk ka kërkesa burokratike
- Regjistrimi në një koalicion/rrjet është i vështirë, por pjesëmarrja është e thjeshtë
- Të dyja, regjistrimi dhe pjesëmarrja në një koalicion/rrjet janë të vështira, me kërkesa burokratike
- Regjistrimi dhe pjesëmarrja në një koalicion/rrjet ndërkombëtar është më e vështirë se në një rrjet kombëtar
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni):

3. Ka hasur organizata juaj ndonjë formë presioni / ndërhyrje jo të ligjshme nga shteti në qeverisjen e brendshme gjatë vitit 2016? (Nëse nuk ka pasur ndonjë formë presioni kalo direkt te pyetja nr. 4)?

Po Jo

3.1. Nëse po, cilat nga format e mëposhtme të presionit / ndërhyrjes jo të ligjshme nga shteti në qeverisjen e brendshme ka përjetuar organizata juaj gjatë vitit 2016? (Ju lutem rrethoni të gjitha alternativat që janë të të aplikueshme):

- Auditim të shpeshtë
- Kontrolle pa njoftim paraprak
- Kontrolle në mjediset e organizatës me njoftim paraprak, por të tepërta
- Kufizime të pajustificuara lidhur me veprimtarinë e organizatës
- Sulme të paligjshme ndaj organizatës
- Kontroll të tepërt mbi rregulloren e brendshme të organizatës
- Aplikim diskriminues i masave administrative, duke përfshirë dhe rregulloren mbi pastrimin e parave
- Kufizime në marrjen e fondeve të huaja
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni):

3.2. Ju lutem shpjegoni rastet e ndërhyrjes nga ana e shtetit që keni përjetuar dhe jepni shembuj:

4. Ka marrë organizata juaj ndonjë sanksion për shkelje ligji gjatë vitit 2016? (Nëse organizata nuk ka marrë sanksion, kalo direkt te pyetja nr. 5)

Po Jo

4.1. Nëse po, si do ti karakterizonit sanksionet me të cilat jeni përballur gjatë vitit 2016?

- Ato kanë qenë të pajustificuara dhe jo në proporcion me natyrën e shkeljes
- Kanë qenë të pajustificuara por në proporcion me natyrën e shkeljes
- Kanë qenë të justifikuara por jo në proporcion me natyrën e shkeljes
- Kanë qenë të justifikuara dhe në proporcion me natyrën e shkeljes
- Tjetër (Ju lutem specifikoni)

4.2. Ju lutem jepni shembuj dhe/ose shpjegime për sanksionet me të cilat jeni përballur gjatë vitit 2016

.....
.....

4.3. A ka pasur organizata të drejtën të apelojë për sanksionet?

- Po, organizata e ka përdorur të drejtën për të apeluar
- Po, por nuk e ka përdorur të drejtën për të apeluar
- Jo, organizata nuk ka pasur të drejtë për të apeluar

4.3.1. Nëse nuk e keni përdorur të drejtën për të apeluar, ju lutem shpjegoni pse?

.....

5. Si do t'i karakterizonit kërkesat raportuese dhe financiare që janë aplikuar për organizatën tuaj gjatë vitit 2016? (Ju lutem rrethoni të gjitha alternativat që janë të aplikueshme)

- Janë të thjeshta dhe të qarta
- Janë në proporcion me madhësinë dhe natyrën e organizatës
- Asnjë nga pohimet e mësipërme.

5.1. Nëse asnjë nga pohimet e mësipërme, ju lutem shpjegoni/specifikon.

.....

6. A kryen organizata juaj aktivitet ekonomik? (Nëse organizata nuk kryen aktivitet ekonomik kalo direkt te pyetja 7?)

Po Jo

6.1. Nëse po, a është përballur organizata juaj me ndonjë sfidë gjatë kryerjes së aktivitetit ekonomik për vitin 2016?)

Po Jo

6.1.1. Cilat janë sfidat me të cilat është përballur organizata juaj gjatë kryerjes së aktivitetit ekonomik për vitin 2016? (Ju lutem rrethoni të gjitha alternativat që janë të aplikueshme)

- Kërkesa të shumta administrative
- Mundësi e kufizuar për t'u përfshirë në aktivitet ekonomik
- Rregulla të komplikuar kontabiliteti
- Trajtim tatimor i komplikuar
- Rregulla raportimi dhe monitorimi të komplikuar
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni)

6.1.2. Ju lutem jepni shpjegime dhe/ose shembuj për secilën nga sfidat e përzgjedhura? :

.....

7. A ka marrë fonde organizata juaj nga donatorë të huaj gjatë vitit 2016? (Nëse nuk ka marrë fonde nga donator të huaj kalo direkt te pyetja nr. 8)?

Po Jo

7.1. Nëse po, a ka hasur organizata juaj ndonjë sfidë nga ana e shtetit në marrjen e fondeve nga donatorë të huaj?

- Po, duhen vërtetime/kërkesa shtesë nga autoritetet shtetërore krahasuar me fondet e marra nga donatorët vendas
- Jo, nuk ka hasur ndonjë sfidë
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni):.....

7.1.1. Ju lutem jepni shpjegime dhe/ose shembuj për secilën nga sfidat e përzgjedhura?

.....

8. Ka marrë organizata juaj fonde nga donatorë privat vendas (duke përfshirë individë, kompani dhe fondacione private) gjatë vitit 2016? Nëse nuk ka marrë fonde nga donatorë privat vendas kalo direkt te pyetja nr.9)?

Po Jo

8.1. Nëse po, cila është përvoja juaj me marrjen e fondeve nga donatorë privat vendas?

- Janë të thjeshta për tu marrë, pa kosto të panevojshme/barrë administrative për organizatën
- Marrja e fondeve ka konsistuar në kosto të panevojshme/barrë administrative për organizatën
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni):

8.2. Ju lutem jepni shpjegime dhe shembuj për çdo rast që jeni përballur me sfida në marrjen e fondeve nga donatorë vendas gjatë 2016:

.....

9. Keni marrë pjesë në ndonjë tubim, individualisht ose përmes organizatës gjatë vitit 2016? (Nëse nuk keni marrë pjesë në ndonjë tubim, kalo direkt te pyetja nr. 11)?

Po Jo

9.1. Keni hasur ndonjë sfidë gjatë pjesëmarrjes në tubim? (Nëse nuk keni hasur ndonjë sfidë gjatë pjesëmarrjes kalo tek pyetja 10):

Po Jo

9.2. Nëse po, cilat janë sfidat me të cilat jeni hasur, duke rrethuar pohimet me të cilat bini dakort (Ju lutem rrethoni të gjitha opsionet që janë të aplikueshme):

- Ka pasur kufizime të tepërta lidhur me vendin e tubimit
- Ka pasur kufizime për të mos lejuar praninë e medias në tubim
- Zyrtarët e zbatimit të ligjit kanë ushtruar forcë mbi pjesëmarrësit
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni)

9.3. Ju lutem shpjegoni ose jepni shembuj mbi kufizimet e tubimit:

.....

10. Keni organizuar ndonjë tubim individualisht apo nëpërmjet organizatës suaj gjatë vitit 2016??

- Yes
- No
- Jo, sepse kërkesa jonë është refuzuar

10.1. Nëse po, tubimi ka qenë spontan, pa njoftuar autoritetet shtetërore?

Po Jo

10.2. A keni hasur ndonjë sfidë gjatë organizimit të tubimit?

Po Jo

10.3. Nëse po, cilat janë sfidat me të cilat jeni hasur? (Ju lutem rrethoni të gjitha alternativat që janë të aplikueshme):

- Një sërë kërkesash administrative të tepërta për organizimin e tubimit
- Kufizimet ishin arbitrare
- Kufizimet nuk ishin të shpjeguara qartësisht
- Ju si organizator jeni përballur me sanksione të pajustificuara para ose pas tubimit
- Ju ose të tjerë nga organizatorët jeni ndaluar për të zhvilluar tubimin
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni)

10.3.1. Shpjegoni sfidat e hasura:

10.4. Kur keni organizuar një tubim, ka pasur ndonjë kundër-tubim⁴² të organizuar??

Po Jo

10.5. Jeni ndjerë të mbrojtur nga zyrtarët e zbatimit të ligjit gjatë kohës që ka ndodhur kundër-tubimi?

Po Jo

10.5.1. Nëse jo, ju lutem shpjegoni cilat ishin arsytet të cilat bënë të ndiheshit i pambrojtur?

.....

11. A keni përjetuar ju dhe organizata juaj ndonjë nga kufizimet e mëposhtme lidhur me lirinë e shprehjes??

	Rregullisht	Ndonjëherë	Një herë	Asnjëherë
Presion kur keni shprehur kritika ndaj autoriteteve shtetërore				
Akuza për fjalime kritike ndaj autoriteteve shtetërore				
Kërcënime për pasjen e pikëpamjeve kundërshtuese me autoritetet shtetërore				
Blokim i aksesit nga autoritetet shtetërore në mjetet e komunikimit online				
Tjetër (Ju lutem shpjegoni):				

12. A keni përjetuar ju dhe organizata juaj ndonjë nga kufizimet si më poshtë lidhur me lirinë e shkëmbimit të informacionit?

	Rregullisht	Ndonjëherë	Një herë	Asnjëherë
Blokimi i ëbsite-ve, kanaleve të komunikimit ose ndonjë platforme online				
Monitorim i paligjshëm i komunikimeve nga autoritetet shtetërore				
Ndëshkime për anëtarësimin në grupe rrjetesh sociale				
Tjetër:.....				

42) Kundër tubimet janë një formë e veçantë e tubimeve të njëkohshme në të cilat pjesëmarrësit dëshirojnë të shprehin mosdakortësinë me pikëpamjet e shprehura në

Fusha 2. Kuadri për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OSHCtë

Informacion i përgjithshëm mbi qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare për OSHCtë

13. Gjatë vitit 2016, sa % e të ardhurave të organizatës janë përfituar nga burimet e mëposhtme (shuma totale e burimeve të ndryshme financiare nuk duhet të kalojë 100%)?

Burimet financiare	2016 (në %)
Fonde publike nga institucionet shtetërore	
Fonde nga pushteti vendor	
Pagesa anëtarësimi	
Dhurime nga individë	
Dhurime nga korporata	
Donatorë të huaj	
Aktiviteti ekonomik	
Investime pasive	
Dhurimet e kushtëzuara	
Tjetër (ju lutem shpjegoni).....	

14. A ka arritur organizata juaj të sigurojë fonde të vazhdueshme për të kryer veprimtarinë e saj gjatë gjithë vitit?

- Po
- Disi, por me shumë sfida
- Jo

14.1. Ju lutem shpjegoni sfidat:

Trajtimi fiskal/tatimor për OSHCtë dhe donatorët e tyre

15. A ka përfituar ndonjëherë organizata juaj përjashtim nga TVSHja për aktivitetin ekonomik dhe cila është përvoja juaj me këtë çështje? (Vetëm për organizatat që kryejnë aktivitet ekonomik)

- Po dhe procedura për të përfituar përjashtimin nga TVSHja ishte e lehtë
- Po, por procedura për të përfituar përjashtimin nga TVSHja ishte e komplikuar
- Po, por procedura për të përfituar përjashtimin nga TVSHja ishte e gjatë
- Ka aplikuar dhe është në pritje të vendimit

- Jo, aplikimi i organizatës është refuzuar
 - Jo, organizata nuk do donte një përjashtim nga TVSHja, sepse nuk ofron ndonjë përfitim në praktikë
 - Jo, nuk është subjekt i përjashtimit nga TVSHja
 - Jo, nuk e di kuptimin "përjashtim nga TVSHja"
 - Tjetër (ju lutem shpjegoni):
- 15.1. Ju lutem shpjegoni më shumë lidhur me përvojën tuaj:

16. Cilat përfitime tatimore ka siguruar organizata juaj? (Ju lutemi rrethoni të gjitha alternativat që janë të të aplikueshme): (Nëse asnjë përfitim, kalo direkt te pyetja nr.18)

- Përjashtime nga tatimi mbi të ardhurat
- Lehtësira tatimore për donatorët tuaj
- Përfitime tatimore lidhur me pronat (psh.ndërtesa)
- Përjashtim nga TVSHja
- Lehtësira nga taksat vendore (ju lutem shpjegoni):
- Lehtësira tatimore për investime pasive
- Asnjë përfitim tatimor
- Tjetër (ju lutem shpjegoni)

17. Nëse keni marrë përfitime tatimore, si i konsideroni procedurat administrative për sigurimin e përfitimeve tatimore?

- Të komplikuar
- Disi të komplikuar
- Jo të komplikuar
- Organizata nuk ka marrë ndonjë përfitim tatimor
- Nuk e di

17.1. Për përgjigjet 1 dhe 2 ju lutem jepni llojin e përfitimit tatimor që ka përfituar dhe shpjegoni shkurtimisht komplikimet:

18. Cilën konsideroni si një sfidë kryesore për zhvillimin e filantropisë në vend? (në rast se zgjedh më shumë se një opsion, ju lutem renditini sipas një rendi zbritës, ku 1 përbën sfidën më të madhe)

- Traditë jo e zhvilluar dhurimi
- Kërkesa ligjore/Procedura administrative të komplikuar
- Incentiva tatimore jo stimuluese për dhuruesit në vend
- Mungesë politikash/strategjish që të inkurajojnë aktivitetin filantropik
- Mungesë kapacitetesh të OSHCve për të komunikuar me dhurues
- Mungesë transparence në shpenzimin e fondeve që shkakton mungesë besimi nga dhuruesit
- Tjetër (ju lutem shpjegoni):

19. A ka incentiva tatimore për donatorët në vendin tuaj? (Nëse nuk ka, apo nuk keni informacion, kalo direkt te pyetja nr. 21)

Po Jo

Nuk kemi informacion në lidhje me kuadrin ligjor mbi përfitimet tatimore për donatorët

20. Nëse po, si do t'i karakterizonit incentivat tatimore për donatorët?

	Dakort	Disi Dakort	Aspak Dakort
Janë të mjaftueshme për të inkurajuar mbështetjen financiare nga ana e donatorëve			
Incentivat tatimore janë të lehta për t'u përfituar nga donatorët			
Tjetër (Ju lutem, specifiko)			

20.1. Komentë::

.....

Mbështetja e shtetit

21. A ka përfituar organizata juaj fonde nga shteti gjatë vitit 2016? (pa përfshirë fondet nga pushteti vendor) (Për organizatat që nuk kanë marrë fonde nga shteti kalo direkt te pyetja nr. 24)

- Po
- Jo, sepse nuk ka aplikuar
- Jo, sepse është refuzuar
- Nuk kemi informacion mbi mundësitë për të marrë mbështetje financiare nga ana e shtetit
- Nuk ka thirrje të hapura për fonde shtetërore

21.1. Nëse po, nga cili institucion ka marrë fonde organizata dhe cila ka qenë shuma e përfituar?

Institucioni	Shuma e fondeve

22. Cili ka qenë qëllimi i fondeve publike të përfituara nga organizata juaj?

- Për një projekt/aktivitet specifik
- Si mbështetje institucionale
- Për projekte të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë ku shteti ka qenë bashkëfinancues
- Tjetër (Specifiko).....

23. Cila është përvoja e organizatës suaj me monitorimin e shpenzimeve të tyre?

(Ju lutem rrethoni të gjitha alternativat që janë të aplikueshme)

- Ju është dashur të dërgoni një raport të detajuar rreth aktiviteteve dhe shpenzimeve
- Ju janë bërë vizita monitoruese me njoftim paraprak
- Ju janë bërë vizita monitoruese pa njoftim paraprak
- Nuk jeni monitoruar
- Tjetër (Ju lutem, shpjegoni)

24. Cili është perceptimi juaj për pohimet e mëposhtme lidhur me financimin publik për OSHCtë?

	Jam Dakort	Jam Disi Dakort	S'jam dakort	Nuk e Di
Fondet publike janë të mjaftueshme dhe i përgjigjen nevojave të OSHCve				
Financimi publik është i parashikueshëm bazuar në alokimin/shpërndarjen që i është bërë në vitet e mëparshme.				
Thirrjet për aplikime janë të rregullta, hapen të paktën një herë në vit				
OSHCtë marrin pjesë në procesin e vendosjes së prioritetëve për financim publik				
Kriteret e përzgjedhjes janë të qarta dhe në dispozicion të publikut				
Kërkesat e aplikimit janë të thjeshta për tu përmbushur				
Format e aplikimit janë të qarta për t'u plotësuar				

Thirrjet për projekt-propozime janë në përputhje me fushën e veprimtarisë së organizatës.				
Thirrjet shpallen publikisht				
Thirrjet e shpallura japin informacion të mjaftueshëm				
Vendimet për shpërndarjen e fondeve janë të drejta, jo në konflikt interesi				
Vendimet për shpërndarjen e fondeve janë publikisht të shpallura				
Informacioni lidhur me shpërndarjen e fondeve është i publikuar në detaje				

25. Ka përfituar organizata juaj ndihmë jo-financiare nga shteti gjatë vitit 2016? (p.sh ambiente pune pa qera, mobilje, pajisje teknike etj.)

- Po, ka marrë përmes një thirrje të hapur
- Po, ka marrë pas një kontakti të drejtpërdrejtë me institucionet shtetërore
- Jo, aplikimi i është refuzuar
- Jo, kërkesa është refuzuar pas një kontakti të drejtpërdrejtë me institucionet shtetërore
- Jo, nuk ka aplikuar për mbështetje jo-financiare nga shteti
- Nuk ka kërkuar mbështetje jo-financiare nga shteti
- Nuk kemi informacion mbi mundësitë për të marrë ndihmë jo-financiare nga shteti
- Tjetër (ju lutem shpjegoni)

25.1. Nëse po, ju lutem shpjegoni çfarë ka përfituar organizata juaj dhe nga cili institucion?:

.....

.....

26. Ka përfituar organizata juaj fonde nga pushteti vendor? (Nëse po, kalo direkt te pyetja nr. 27)

Po Jo

26.1. Nëse jo, cila është arsyeja pse nuk ka përfituar fonde nga pushteti vendor?

- Nuk ka pasur thirrje të hapur për OJFtë
- Organizata nuk ka pasur nevojë për një mbështetje të tillë
- Nuk ka aplikuar për të marrë fonde nga pushteti vendor
- Aplikimi është refuzuar
- Nuk kemi informacion mbi mundësitë për financim nga pushteti vendor

Burimet Njerëzore

27. Ka përfituar organizata juaj nga programi i incentivave shtetërore për punësimin?

- Po (ju lutem shpjegoni)
- Jo, sepse asnjë nga ato incentiva nuk kanë qenë të aplikueshme për organizatën
- Jo, sepse incentivat nuk janë interesante/stimuluese mjaftueshëm
- Jo, sepse organizata nuk ka punësuar ndonjë punonjës vitin e fundit
- Jo, sepse nuk kemi informacion mbi programet e incentivave shtetërore të punësimit
- Tjetër (ju lutem shpjegoni):

27.1. Komentet:

.....

28. A jeni në dijeni të kuadrit ligjor mbi Vullnetarizmin?

Po Jo

28.1. Nëse po, si do e vlerësonit kuadrin ligjor mbi Vullnetarizmin?

	Jam Dakort	Jam Disi Dakort	S'jam dakort	Nuk e di
Kuadri ligjor stimulon angazhimin vullnetar				
Procedurat administrative janë të thjeshta				
Kostot e procedurave administrative janë të ulëta				
Kuadri ligjor mundëson vullnetarizmin spontan				
Detyrimet që parashikon kuadri ligjor për organizatorët janë të arsyeshme				
Detyrimet që parashikon kuadri ligjor për vullnetarët janë të arsyeshme				
Procedura për vullnetarët e huaj është e njëjtë si për vullnetarët vendas				

Fusha 3. Marrdhënia Qeveri-OSHC

Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

29. A jeni në dijeni të ekzistencës së dokumentave strategjik për bashkëpunim OSHC-qeveri? (Nëse nuk jeni në dijeni, kalo direkt te pyetja nr. 30)

Po Jo

29.1. Nëse po, a ka qenë organizata juaj e përfshirë në zbatimin e tyre??

- Po, ka qenë e përfshirë në zbatimin e tyre
- Po, ka qenë ndonjëherë e përfshirë në zbatimin e tyre
- Jo, nuk ka qenë e përfshirë në zbatimin e tyre
- Tjetër (ju lutem shpjegoni):.....

29.2. Ju lutem ndani përvojën tuaj lidhur me procesin zbatues, duke u bazuar te alternativa e zgjedhur:

30. A jeni në dijeni të ndonjë organizmi/institucioni specifik për bashkëpunimin shtet - OSHC? (Nëse jo, kalo direkt te pyetja nr. 31)

Po Jo

30.1. Nëse po, kush është ky organizëm dhe si do ta vlerësonit bashkëpunimin me këtë organizëm:.....

Përfshirja në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes

31. Ka dërguar organizata juaj ndonjë kërkesë për informacion në institucionet shtetërore gjatë vitit 2016? (Nëse nuk ka dërguar ndonjë kërkesë për informacion, kalo direkt te pyetja nr. 32)

Po Jo

Nuk kemi informacion mbi mundësinë për të kërkuar informacion

31.1. Nëse po, kur organizata ka kërkuar informacion me interes publik:

Ka marrë informacion brenda kohëzgjatjes së parashikuar në ligj

Ka marrë informacion me vonesë

Kërkesa për informacion është refuzuar

Ka marrë pjesërisht informacionin e kërkuar

Nuk ka marrë asnjë përgjigje

Tjetër (ju lutem shpjegoni)

31.2. Ju lutem jepni shembuj dhe shpjegime mbi sfidat e përjetuara në lidhje me kërkesat për informacion:

32. Nga përvoja juaj, vlerëso pohimet e mëposhtme mbi publikimin e projektligjeve, politikave dhe ligjeve?

	Jam Dakort	Jam Disi Dakort	S'jam dakort
Projektligjet, politikat, ligjet publikohen dhe vihen në dispozicion të publikut			
Projektligjet, politikat, ligjet publikohen në kohën e duhur			
Tjetër (Specifikoni).....			

33. Është thirrur organizata juaj për të marrë pjesë në procesin e konsultimeve mbi politika dhe projektligje gjatë vitit 2016? (Nëse jo, kalo direkt te pyetja nr. 34)

Po Jo

31.1. Nëse organizata juaj është thirrur në konsultime me autoritetet publike mbi politika dhe projekt-ligje gjatë vitit të fundit, si do t'i vlerësonte këto procese? (Ju lutem rrethoni të gjitha alternativat që janë të aplikueshme)?

	Jam Dakort	Jam Disi Dakort	S'jam dakort
Organizata është ftuar në konsultime që në faza të hershme, në fillim të procesit legjislativ dhe të hartimit të politikave.			
Organizata ka pasur kohë mjaftueshëm për t'u përgjigjur.			
Organizata ka pasur informacionin e duhur në dispozicion mbi përmbajtjen e projektligjit/politikës që do diskutohej.			
Pjesa më e madhe e punonjësve civil kanë kapacitetet e duhura për hartimin e projektligjeve/politikave.			
Punonjësit civil të caktuar kanë dhënë këshilla/informacion të dobishëm mbi konsultimet, procesin dhe planet.			
Të gjitha rekomandimet janë reflektuar.			
Pas konsultimeve të zhvilluara janë vënë në dispozicion të publikut shpjegime pse rekomandimet e dhëna nuk janë marrë parasysh.			

34. A ka nisur/është përpjekur të nisë organizata juaj një dialog me autoritetet publike rreth zhvillimit të një dokumenti politikash apo projekt-ligji?

- Po dhe ka marrë përgjigje nga autoritetet publike
- Po por nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga autoritetet publike
- Jo

34.1. Në rast të nisjes së një dialogu me autoritetet publike, ju lutem ndani përvojën tuaj dhe rezultatet e diskutimit të zhvilluar:

.....

.....

35. A është përzgjedhur dikush nga organizata juaj për të marrë pjesë në një organizëm këshillues/konsultues shtetëtor gjatë vitit 2016? (Nëse nuk keni qenë pjesë e organizmave këshillues, kalo direkt te pyetja nr. 36)

Po Jo

35.1. Nëse po në sa organizma këshillues/konsultues kanë marrë pjesë përfaqësuesit e organizatës suaj dhe cilat janë emrat e këtyre organizmave?

.....

.....

35.2. Nëse keni qenë pjesë e organizmave këshillues/konsultues, si do t'ii vlerësonit pohimet e mëposhtme?

	Jam Dakort	Jam Disi Dakort	S'jam dakort
Organizmi kishte burime financiare të mjaftueshme për të lehtësuar dialogun OSHC-Qeveri.			
Organizmi kishte burime njerëzore të mjaftueshme për të lehtësuar dialogun OSHC-Qeveri.			
Organizmi është aktiv dhe konsulton në mënyrë të vazhdueshme me OSHCtë mbi projekt-ligjet dhe politikat.			
Përfaqësuesit e OSHCve janë përzgjedhur përmes një procedure publike të shpallur dhe transparente.			
Aktivitetet e organizmit konsultues janë shpallur me përpikmëri			
Politikat dhe ligjet e diskutuara janë kritikuar lirisht			
Puna e këtij organizmi këshillues është transparente			
OSHCtë që marrin pjesë në organizma këshillues shkëmbejnë informacion me OSHCtë e tjetra lidhur me punën e organizmit këshillues.			

36. Nëse organizata nuk ka qenë pjesë e ndonjë organizmi këshillues/konsultues, cilat janë arsyet?

- Nuk ka pasur thirrje publike për pjesëmarrje në fushën në të cilën ushtron aktivitetin organizata
- Nuk ka organizma këshillues në fushën në të cilën organizata ushtron aktivitetin
- Nuk ka kërkuar të marrë pjesë
- Nuk ka dashur të marrë pjesë
- Ka aplikuar, por është refuzuar
- Tjetër (specifiko)

Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

37. Ka konkurruar organizata juaj për kontrata shtetërore

- Po, dhe ka marrë fonde nga kontratat shtetërore
- Po, por nuk ka marrë fonde (ju lutem shpjegoni):
- Jo (ju lutem specifiko arsyet):

37.1. Nëse organizata ka konkurruar dhe ka përfituar fonde, specifiko nga kush institucion dhe për çfarë shërbimi është kontraktuar?

Institucioni	Shërbimi i ofruar

Ju lutem vazhdoni me pyetjet e mëposhtme vetëm nëse organizata juaj ka konkurruar për kontrata shtetërore.

38. Ka qenë organizata juaj e përfshirë në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve (vlerësim nevojash, përzgjedhje, fazën e vlerësimit etj)?

- Po, në të gjitha
- Po, por vetëm në disa (ju lutem specifikoni në cilat):
- Jo, në asnjë

39. A ka hasur organizata juaj ndonjë sfidë gjatë procesit të aplikimit? (Nëse nuk ka hasur ndonjë sfidë, kalo direkt te pyetja nr. 41)

Po Jo

40. Nëse po, me cilat nga sfidat e mëposhtme është përballur organizata juaj? (Ju lutem rrethoni të gjitha alternativat e aplikueshme)

- Kërkesa administrative të tepërta
- Procedura licensimi/regjistrimi të komplikuar
- Përgjashtim nga konkurrenca pa një arsyetim objektiv

- Vendorsja e kritereve që avantazhojnë biznesin
- Numër i kufizuar i tenderave publik në fushën tuaj të veprimtarisë
- Procesi i tenderimit nuk ka qenë transparent
- Tjetër (ju lutem shpjegoni)

40.1. Ilustroni me një shembull sfidat e hasura:

41. Si do t'i vlerësonit fondet e përfituara nga kontratat shtetërore?

- Mbulonin të gjitha kostot bazë të shërbimit që keni ofruar, duke përfshirë dhe shpenzimet përkatëse të institucionit/administrative
- Mbulonin të gjitha kostot bazë të shërbimit që keni ofruar, por jo shpenzimet e institucionit/administrative
- Nuk kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot bazë të shërbimit të ofruar
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni)

41.1. Ju lutem jepni shpjegime dhe shembuj për pohimet e përzgjedhura:

42. Nga përvoja e organizatës suaj, a janë marrë në kohën e duhur fondet nga kontratat shtetërore?

- Janë marrë në kohë
- Janë vonuar, duke sjellë pengesa për vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit
- Janë vonuar, por humbjet e shkaktuara nga vonesat janë dëmshpërblyer
- Tjetër (Ju lutem shpjegoni):

42.1. Ju lutem jepni shpjegime dhe shembuj mbi pohimet e përzgjedhura:

Faleminderit për kontributin tuaj!

RAPORTI PËR SHQIPËRINË
2016